

Avni Xhelili

Emrat e përveçëm letrarë dhe problemet e transmetimit të tyre nga gjuha ruse

Përmbledhje

Emrat e përveçëm (antroponimet, toponimet) janë komponent shumë i rëndësishëm i strukturës së tekstit letrar. Ata marrin pjesë në ndërtimin dhe zhvillimin e kompozimit letrar dhe ligjërimor të tekstit, përmbajnë informacion historik e kulturor për shoqërinë, së cilës i përkasin, ndihmojnë në zbërthimin e ideve artistike të autorit. Huazimi i tyre nga njëra gjuhë në tjetrën është një proces i vështirë që kërkon qasje të kujdesshme e profesionale nga përkthyesi. Në artikull bëhen përpjekje për të përgjithësuar përvojën e përkthyesve tanë në transmetimin e njësive antroponimike e toponimike, të përdorura në letërsinë ruse. Nga vëzhgimet e mbi 30 veprave letrare të përkthyer dolën në pah jo pak probleme e çështje të diskutueshme, pasaktësi e gabime në huazimin e emrave të përveçëm realë dhe emrave të krijuar nga autori i veprës. Në material bëhet një përshkrim i shkurtër i teknikave përkthimore më të përdorura për transmetimin e emrave të përveçëm në gjuhën shqipe, sillen shembuj kur dhe pse duhet përdorur njëra ose tjetra teknikë përkthimore dhe në cilat raste përdorimi i tyre është i kufizuar. Janë saktësuar ose formuluar disa rregulla të reja për transkriptimin praktik të njësive antroponimike e toponimike të rusishtes, alfabeti cirilik i së cilës jo në të gjitha rastet përkon me mjetet grafike të shqipes. Artikulli ofron qasje e zgjidhje përkthimore konkrete, të cilat synojnë shmangien ose minimizimin e pasaktësive dhe gabimeve gjatë kalimit në gjuhën shqipe të emrave të përveçëm të onomastikës letrare ruse.

Fjalë kyçe: *antroponim, toponim, transmetim, vepër letrare, emër i përveçëm, emër real, emër i trilluar, transkriptim, transliterim, kalkim.*

I. Emrat e përveçëm dhe funksioni i tyre në tekstin letrar

Emrat e përveçëm që përdoren në letërsinë artistike përbëjnë shtresën më të madhe të leksikut onomastik. Për këtë shtresë studiuesit përdorin termin *onomastika letrare*, e cila merret me veçoritë e funksionimit të emrave të

përveçëm në tekstin letrar. Nuk mungojnë edhe terma të tjerë alternativë si *onomastika poetike*, *onomastika stilistike* e ndonjë tjetër (Ковалёв, 2014, 447). Onomastika letrare përfshin kategoritë e antroponimeve, toponimeve, hidronimeve, zoonimeve si dhe disa njësi të tjera të leksikut onomastik: teonimet, astronimet, kozmonimet etj. Për të gjitha këto njësi leksikore përdoret edhe termi i përbashkët *onim letrar* që përfaqëson çdo emër të përveçëm të letërsisë artistike.

Në një vepër letrare hasen të gjitha llojet e antroponimeve dhe toponimeve: emra, mbiemra njerëzish, pseudonime, nofka; emërtime gjeografike vendbanimesh, vendesh, malesh, detesh, lumenjsh, liqenesh e objektësh të tjera. Ata janë jo thjesht emra të përveçëm që ekzistojnë në onomastikën e përgjithshme të gjuhës, por edhe emra që shkrintari i trillon, i krijon vetë. Shpesh ai u jep personazheve të tij emra karakterizues, të cilët shprehin thelbin e tyre.

Si elemente funksionale të strukturës tekstore, emrat e përveçëm lidhen organikisht me gjininë, tematikën, përmbajtjen dhe karakterin e personazheve të veprës letrare. Ata marrin pjesë në ndërtimin dhe zhvillimin e kompozimit letrar dhe ligjërimor të tekstit. Për studiuesin Gorbanevski antroponimet dhe toponimet “janë elemente të pandashme të formës së veprës, janë një ndër mjetet e krijimit të figurës letrare. Ata mund të mbajnë edhe ngarkesa semantike, mund të kenë edhe një sfond lidhesh të padukshme, mund të kenë dhe veshje tingullore të veçantë; emrat e përveçëm janë në gjendje të pasqyrojnë epokën historike e të përcjellin koloritin e vendit, ku dhe kur zhvillohen ngjarjet e veprës letrare; ata kanë tipare sociale”. (Горбаневский 1988, 87).

Emrat e përveçëm të veprës letrare nuk mund të jenë të rastësishëm, ata përzgjidhen nga autori në përputhje me qëllimet ideoartistike që i vë vetes në një rënë ose tjetrën vepër. Si rregull, në përzgjedhjen e emrave të personazheve shkrintari mbështetet në burimet onomastike që veprojnë në gjuhë, përdor emra të njohur realë si *Aleksandër*, *Boris*, *Ivan*, *Maria*, *Sergei* etj. Midis bartësit (personit) dhe emrit nuk ka lidhje të brendshme. Emra të tillë janë asemantikë, nuk kanë kuptim, ata vetëm emërtojnë e identifikojnë bartësit e tyre. Në “Fjalorin e terminologjisë onomastike ruse” emri i përveçëm përkufizohet si “fjalë ose togfjalësh që shërben për dallimin e objektit të emërtuar midis objekteve të tjera, për individualizimin dhe identifikimin e tij” (Подольская 1988, 192).

Në letërsinë artistike ndodh jo rrallë që shkrintari për realizimin e idesë artistike, të krijojë për personazhet e veprës emra që kanë kuptim, që përmbajnë informacion të caktuar. “Emri semantik është trop i veçantë, i ngjashëm në një farë mase me metaforën dhe krahasimin, dhe përdoret për të karakterizuar stilistikisht një personazh ose mjedis shoqëror. Emrat semantikë shpiken nga autori kur ndjek qëllime të caktuara, për krijimin e tyre ai mbështetet në traditat dhe modelet ekzistuese të onomastikës” (Виноградов 2006, 162). Funkzioni i tyre është jo vetëm të tregojnë objektin, por edhe ta karakterizojnë atë, zakonisht nga këndvështrimi ironik ose satirik. P.sh.

mbiemri i trilluar rus *Shatov* flet për një personazh me karakter të luhatshtëm, të paqëndrueshëm, *Sobakjeviç* - personifikon botën shtazore, i prirë për shtazëri, *Oçumellov* - i marrë, i lajthitur, *Koroboçka* - primitive, e mbyllur si kuti, *Manillov* - i plogësht, ëndërrimtar, *Raskolnikov* - me ndërgjegje e shpirt të dyzuar, të copëtuar, *Marmelladov* - vullnetdobët, i butë si marmelatë.

Njësitë antroponimike e toponimike janë produkt i një epoke dhe kulture të caktuar, të lidhur ngushtë me historinë e gjuhës dhe të kulturës së popujve. Ato pasqyrojnë periudha të tëra historike, kontaktet midis kulturave të ndryshme, mënyrën e jetesës së njerëzve, besimet, aspiratat, fantazitë e mendësitë e tyre, nxjerrin në pah veçoritë kulturore kombëtare të një etnie të caktuar. Nga emri/mbiemri i personazhit lexuesi mund të njihet me identitetin e tij etnik, kulturor e fetar, me përkatësinë historike të emrit (cilës periudhë historike i përket), me kuptimin metaforik dhe simbolikën që përfaqëson në tekstin letrar. Mbatja parasysh e këtyre veçorive është me rëndësi parimore për përkthyesin, sepse i jep mundësi të transmetojë korrekt emrat e përveçëm, të minimizojë shtrembërimet që lidhen me rrethanat historike, kulturore e kombëtare të tekstit origjinal (Спачиль 2021, 172).

Emrat vetjakë në gjuhën ruse kanë prejardhje të ndryshme, një pjesë e tyre janë me burim nga sllavishtja e vjetër: a) emra të traditës pagane: *Первак* (Pervak) – ‘i pari’, *Вторак* (Vtorak) – ‘i dyti’, *Третьяк* (Tretjak) – ‘i treti’, *Шестак* (Shestak) ‘i gjashti’ (emra fëmijësh sipas radhës së lindjes), *Ждан* (Zhdan) – (fëmijë) ‘i shumëpritur’, *Нечай* (Neçaj) – (fëmijë) ‘i padëshiruar’, *Поспел* (Pospell) – (fëmijë) ‘i ardhur në kohë’. Emra të tillë prej kohësh nuk u vihen të porsalindurve, por prej tyre janë formuar mbiemra, të cilët përdoren edhe sot: *Третьяков* (Tretjakov), *Шестов* (Shestov), *Жданов* (Zhdanov), *Нечаев* (Neçajev), *Поспелов* (Pospellov) etj.; b) emra të tjerë dygjimtyrësh: *Владимир* (Vlladimir), *Всеволод* (Vsevolod), *Вячеслава* (Vjaçesllava), *Любомила* (Ljubomilla), *Святослав* (Svjatosllav).

Shumica e antroponimeve ruse i përket sistemit të emrave ortodoksë të traditës bizantine, të cilët depërtuan në Rusi nga fundi i shek. X së bashku me krishterimin dhe ritin e pagëzimit: *Александр* (Aleksandër), *Алексей* (Aleksi), *Андрей* (Andrei), *Василий* (Vasili), *Иван* (Ivan), *Лариса* (Llarisa), *София* (Sofia). Krahas emrave të mirëfilltë grekë, në gjuhën ruse depërtuan edhe emra me burim latin, hebraik ose nga ndonjë gjuhë tjetër: *Виктор* (Viktor), *Виталий* (Vitali), *Михаил* (Mihail), *Яков* (Jakov). Sot gjejmë edhe emra nga gjuhët perëndimore, si *Альберт* (Albert), *Артур* (Artur), *Леонард* (Leonard), *Эдуард* (Eduard), por ata nuk kanë përhapje të gjerë. Haset edhe një numër i vogël emrash të përveçëm me prejardhje nga gjuhët skandinave: *Глеб* (Gelb), *Игорь* (Igor), *Олег* (Oleg), *Ольга* (Olga).

Si objekt i huazimit ndërgjuhësor e ndërkulturor, transmetimi në përkthim i emrave të njerëzve dhe i emërtimeve gjeografike është një proces i vështirë, jo rrallë i shoqëruar me zgjidhje përkthimore të diskutueshme ose të qortueshme.

Detyra e përkthyesit bëhet edhe më e vështirë, kur përkthimi me shkrim realizohet nga gjuhë me sisteme alfabetike të ndryshme nga shqipja, siç është rasti i rusishtes ose i gjuhëve të tjera sllave që përdorin alfabetin cirilik.

Nuk mund të lihen jashtë vëmendjes edhe veçantitë e sistemeve antroponimike në gjuhë të ndryshme si dhe traditat kombëtare në vendosjen e emrave, p.sh., sistemi antroponimik i shqipes përbëhet nga dy komponentë, emri + mbiemri (*Dritan Gjata*), i cili ngjason me shumicën dërrmuese të gjuhëve europiane. Ndryshe nga kjo traditë, në kulturën ruse sistemi antroponimik përbëhet nga tre komponentë: emri + atësia + mbiemri (*Boris Sergejeviç Kolesnikov*), rendi i të cilëve mund të ndryshojë. Në dokumentet zyrtare në fillim shkruhet mbiemri, pas tij emri dhe në fund atësia: (*Kolesnikov Boris Sergejeviç*). Në praktikën e përditshme mund të përdoren vetëm emri dhe atësia (*Boris Sergejeviç*) si formë mirësjelljeje e respekti, ose emri dhe mbiemri (*Boris Kolesnikov*), në rastet kur u drejtohem i moshave më të reja, p.sh. nxënësve të shkollave. Atësia për emrat me disa variante *Михаил* (Mihail), *Михаила* (Mihaila), *Михайло* (Mihajlo) është vetëm një, *Михайлович* (Mihajloviç për gj. m.), *Михайловна* (Mihajlovna për gj.f.) ose për variantet *Гавриил*, (*Gavriill*) *Гаврил* (*Gavrill*), *Гаврила* (*Gavrilla*), *Гаврило* (*Gavrillo*) ekziston vetëm atësia *Гаврилович* (*Gavrilloviç* për gj. m), *Гавриловна* (*Gavrillovna* për gj. f.). Emrat vetjakë në gjuhën ruse përdoren shpesh edhe në formë të shkurtuar (jozyrtare), p.sh. nga *Александр* (Aleksandër) — *Саша* (*Sasha*), *Сашира* (*Sashura*), *Шура* (*Shura*), *Саня* (*Sanja*), *Шурик* (*Shurik*); nga *Мария* (*Maria*) — *Маши* (*Masha*), *Машика* (*Mashka*), *Маня* (*Manja*), *Муся* (*Musja*) etj.

Siç është e njohur, përkthimi letrar është veprimtari komplekse, ku ndeshen kultura të ndryshme, mënyra të ndryshme të të menduarit, periudha dhe nivele të ndryshme zhvillimi, letërsi e tradita të ndryshme. Kur përkthyesi mbart një vepër letrare të një kulture të huaj, ai i jep asaj jetë në një mjedis të ri gjuhësor dhe kulturor, e rikrijon atë, rikrijon frymën e një epoqe dhe kulture tjetër. Përkthimi është sa komunikim ndër-gjuhësor, aq edhe komunikim ndërkulturor. Për studiuesin A. D. Shvejcer "...përkthimi është jo vetëm një akt ligjërimor, por edhe një akt i bashkëveprimit të dy kulturave" (Швейцер 1988, 215). Bartja e kulturës së huaj në kulturën pritëse është një proces aspak i lehtë për përkthyesin, i cili kryen rolin e ndërmjetësit midis dy gjuhëve dhe dy kulturave në kontakt. Ruajtja e veçorive gjuhësore, stilistike, historike, kulturore e kombëtare të origjinalit është një ndër vështirësitë e shumta, me të cilat përballet përkthyesi, veçanërisht kur bëhet fjalë për transmetimin e njëjësive leksikore pa barasvlerës në gjuhën e përkthimit. Elemente të tilla leksikore, apo siç quhen ndryshe *realie* ose *kulturonime*, shënojnë veçori etnonacionale, objekte a dukuri të kulturës materiale e shpirtërore, procese a fakte historike, zakone e rite, të cilat i përkasin vetëm kulturës që i ka prodhuar. Ato nuk kanë përkime në fjalorë të gjuhëve të tjera. Te kjo shtresë leksikore studiuesit përfshijnë edhe emrat e përveçëm, si elemente me ngjyrim kombëtare e

historike. Sipas P. Newmark, “antroponimet janë njësi pa barasvlerës që nuk përkthehen” (Newmark 1988, 70).

Ky shkrim i kushtohet pikërisht problematikës që shoqëron transmetimin në shqip të njësive leksikore antroponimike dhe toponimike në përkthimet e letërsisë artistike ruse, e cila në Shqipëri përkthehet e ripërkthehet prej më shumë se 100 vitesh. Përkthyesit tanë kanë meritën e madhe se mundën të sjellin në gjuhën shqipe veprat më të arrira të letërsisë ruse, bartëse të vlerave kulturore mbarënjerezore. Falë talentit, pasionit dhe përkushtimit të tyre lexuesit tonë i kanë rënë në dorë vepra elitare të një bote letrare të panjohur për të. Praktika përkthimore e kësaj letërsie ka krijuar një traditë e mirë në transmetimin e emrave të përveçëm nga rusishtja cirilike. Përvoja e fituar është një bazë e mirë për të realizuar përkthime edhe më cilësore.

II. Metoda e parime për transmetimin e antroponimeve dhe toponimeve letrare ruse

Sikurse u vu në dukje, emrat e përveçëm janë njësi leksikore që s’kanë barasvlerës në gjuhë të tjera, janë unikë dhe të papërsëritshëm në llojin e tyre. Si rregull, ata nuk përkthehen, sepse funksioni i tyre emërtues është mbizotërues ndaj funksionit komunikativ, plani shprehës e errëson planin përmbajtësor (Влахов & Флорин 1980, 416). Është kjo arsyeja që për huazimin e emrave të përveçëm në përkthim studiuesit prirën të përdorin termin “transmetim” dhe jo “përkthim”.

Metoda e transmetimit të emrave të përveçëm të një teksti letrar të huaj në përkthim nuk mund të jetë universale. Jo të gjitha gjuhët përdorin të njëjtin alfabet: të tjera teknika përdoren kur përkthimi realizohet brenda gjuhëve që kanë sistem të përbashkët grafik (latin, cirilik, arab etj.) dhe të tjera kur përkthimi realizohet në gjuhët që përdorin alfabete të ndryshme, siç është rasti i përkthimit nga rusishtja cirilike në gjuhën shqipe me alfabet latin ose anasjelltas. Mënyrat më të përhapura për transmetimin e njësive antroponimike dhe toponimike nga gjuha ruse janë transkriptimi, transliterimi, kalkimi ose kombinimi i tyre. Mund të përdoret edhe përkthimi i emrit të përveçëm, por vetëm si përjashtim.

E shohim me vend të bëjmë një dallim kuptimor midis termave “kalkim” dhe “përkthim”, të cilët ndonjëherë merren si fjalë sinonimike. Kalkimi përdoret për transmetimin në përkthim të emrave të përveçëm, kryesisht të emrave gjeografikë dhe në përgjithësi të leksikut pa barasvlerës, me anë të riprodhimit të strukturës morfemore dhe leksikore të fjalës a togfjalëshit, ndërsa përkthimi, ndryshe nga kalkimi, është një term i përgjithshëm që mund të përfshijë metoda dhe qasje të ndryshme për bartjen e kuptimit të tekstit burimor në gjuhën pritëse. Pra, ndryshimi midis termave “kalkim ” dhe “përkthim” lidhet me aspektet dhe qëllimet e tyre të veçanta në praktikën e përkthimit. Zgjedhja e teknikave të mësipërme varet nga veçoritë a struktura e

emrit të përveçëm që do të transmetohet, nga konteksti ku është përdorur, nga tradita e ngulitur, por edhe nga faktorë të tillë si: mënyra e shkrimit të emrit në gjuhën ruse, mundësitë e alfabetit të gjuhës shqipe, mënyra e shqiptimit dhe ndonjë faktor i jashtëm, si p.sh. ndikimi i modeleve përkthimore në gjuhë të tjera europiane.

Teknika e transkriptimit mbështetet në riprodhimin fonetik sa më afër fjalës së huaj. “Sa më afër” do të thotë aq sa e lejon fonetika e gjuhës pritëse. Në rastin e përkthimit nga rusishtja në gjuhën shqipe ruajtja qind për qind e tingëllimit të njësisë antroponimike ose toponimike nuk mund të arrihet, sepse alfabetit të saj latin i mungojnë disa fonema a tinguj të rusishtes. Transkriptimi më i afërt i antroponimit *Юрий Аксёнович Щербатых* do të jetë *Juri Aksjonoviç Shçerbatih*, ku grafemat ruse *ю, ё, и, ы* janë zëvendësuar me mjetet e përafërta grafike të shqipes, përkatësisht *ju, jo, shç, i*. Pavarësisht nga modifikimet që ka pësuar antroponimi origjinal i rusishtes, ai në shqip ruan origjinalitetin dhe ngjyrimin kombëtar.

Ndryshe nga transkriptimi, teknika e transliterimit riprodhon shkronjë pas shkronje emrat e përveçëm të origjinalit me shkronjat e alfabetit të gjuhës pritëse, pra imiton grafiksht formën e fjalës së huaj. Kjo ndodh në rastet kur elementet e sistemit grafik të dy gjuhëve përkojnë: *Иван Иванович Дуров – Ivan Ivanoviç Durov, Остап Уваров – Ostap Uvarov, Инга Зотова – Inga Zotova, Пушкин – Pushkin, Сидоров – Sidorov, Габович – Gaboviç; Камчатка – Kamçatka, Мурманск – Murmansk, Томск – Tomsk, Самара – Samara, Дон – Don, Волга – Vollga, Чукотка – Çukotka*. Nëse do të bënim transliterimin e anasjelltë (nga shqipja në rusisht), rezultati do të ishte i njëjtë (*Ivan Ivanoviç Durov – Иван Иванович Дуров, Камчатка – Камчатка*). Siç mund të vihet re, varianti grafik i emrave/mbiemrave vetjakë dhe emërtimeve gjeografike të shembujt e mësipërm në gjuhën shqipe nuk është modifikuar, identifikimi i bartësve të tyre është i pavarur nga gjuha.

Mosndryshimi i formës shkrimore përbën anën pozitive të transliterimit, por në shumë raste të tjera emri i transliteruar shpesh shqiptohet sipas rregullave të leximit në gjuhën shqipe, p.sh. emri *Олег Сквородников* tradicionalisht transliterohet në shqip si *Oleg Skovorodnikóv*, kështu dhe lexohet (me kalim të theksit në rrokjen e fundit). Ky riprodhim, edhe pse shumë i ngjashëm me origjinalin, nuk përkon me fonetikën e rusishtes, sepse jo gjithnjë shkronja pasqyron të njëjtin tingull. Bartësi i rusishtes emrin e mësipërm e lexon përafërsisht si *Alek Skavarodnjikof*, ku shkronja *o*, p.sh. në disa pozicione shqiptohet përafërsisht si *a*, kurse shkronja *z* në fund të fjalës si *k*. Një shqiptim i tillë në përkthim nuk gjen pasqyrim as në shqip dhe as në gjuhë të tjera. Transkriptimet e hollësishme fonetike me anë të simboleve të veçanta u duhen kryesisht specialistëve për qëllime shkencore, për të studiuar strukturën tingullore të gjuhës, por jo përkthyesve.

Transliterimi nuk është zëvendësim i thjeshtë i mjeteve alfabetike të gjuhës ruse me mjetet e gjuhës shqipe. Shpesh transliterimi paraqet vështirësi, jo të gjithë tingujt e rusishtes mund të pasqyrohen me mjetet grafike të shqipes. Siç u vu në dukje, shqipes i mungojnë disa grafema cirilike të rusishtes, p.sh. fonema **щ** zëvendësohet me digrafën **shç** (*Зошченко – Zoshçenko*), grafemat dytingullore **я** (j+a), **е** (j+e), **ё** (j+o), **ю** (j+u) jepen në shqip me **ja** (*Яков – Jakov*, *Демьян – Demjan*), me **je** (*Леонтьев – Leontjev*, *Екатерина – Jekaterina*), me **jo** (*Семён Ёжкин – Semjon Jozhkin*), me **ju** (*Юрий – Juri*, *Челюскин – Çeljuskin*), ndërsa fonema **ы** me **i** (*Таймыр – Tajmir*, *Кыргызстан – Kirgizstan*). Ndryshimet fonetike në shembujt e sjellë janë pasojë e dallimeve që kanë sistemet fonetike të rusishtes dhe shqipes.

Nëse gjatë transliterimit përkthyesit i intereson vetëm paraqitja grafike e njësisë antroponimike ose toponimike, gjatë transkriptimit mbahen parasysh: ana fonetike e fjalës së huaj, ana grafike e saj, fonemat, roli morfologjik i elementeve përbërëse që duhen transmetuar. Pra, kur transkriptojmë vëmendja kryesore përqendrohet në ruajtjen e fjalës si njësi tërësore, ndërsa kur transliterojmë merret parasysh kryesisht përkimi i mjeteve grafike të dy sistemeve alfabetike, kurse tingujt që fshihen pas tyre, thuajse shpërfillen.

Në shumicën e rasteve kemi të bëjmë me transkriptime a transliterime jo të pastra. Teknikat e transliterimit dhe transkriptimit nuk e përjashtojnë njëra-tjetrën, sidomos kur përkthejmë nga gjuhë me sisteme të ndryshme grafike. Këto dy mënyra kryqëzohen, shpërfaqin një lloj simbioze. Transkriptimi që përfshin edhe elemente të transliterimit njihet në praktikën përkthimore si parimi i *transkriptimit praktik*. “Transkriptimi praktik është mjet për të përfshirë fjalë të një gjuhe në tekstin e një gjuhe tjetër duke ruajtur përafërsisht veshjen tingullore të këtyre fjalëve. Përafërsia e transkriptimit praktik është pasojë e mospërputhjes së një numri të caktuar fonemash në gjuhë të ndryshme”. (Гиляревский & Старостин 1985, 303).

Transkriptimi praktik synon të përmbushë njëherazi disa kërkesa: ruajtjen e përafërt të veshjes tingullore të fjalës që transmetohet, ruajtjen e strukturës morfemike të saj, pasqyrimin e të gjithë sistemit fonologjik të gjuhës burimore, pasqyrimin e anës grafike të origjinalit, sidomos në rastet kur përkthyesi kompenson pamundësinë për të riprodhuar tingullin, mbajtjen parasysh të traditave të ngulitura, përfrimin e paraqitjes fonetike, grafike dhe gramatikore të njësisë leksikore të huaj me sistemin e gjuhës pritëse (Суперанская 2018, 288).

Teknika e transkriptimit praktik duhet të respektojë parimin e përkimit të ndërsjellë midis fonemave të gjuhës burimore dhe mjeteve grafike të gjuhës së përkthimit, por një synim i tillë jo gjithnjë mund të arrihet. Përbërja fonetike e gjuhëve herë-herë ndryshon shumë dhe e bën të vështirë shqiptimin e disa elementeve të fjalëve. Nga kjo del se transmetimi grafikisht i pastër, me përjashtime të rralla, nuk mund të jetë fonetikisht i saktë, ashtu si transmetimi fonetik nuk garanton ruajtjen e identitetit grafik të fjalës. Fonetizmi i tepruar në

transmetimin e antroponimeve dhe toponimeve errëson formën e vërtetë të fjalës. Ruajtja e identitetit të emrit është me rëndësi për praktikën përkthimore.

Në literaturën gjuhësore bëhet fjalë edhe për metodën e bartjes (kalimit) pa asnjë ndryshim grafik të emrave të përveçëm në gjuhën pritëse, pra emri i përveçëm shkruhet në tekstin e përkthimit saktësisht me po ato simbole, si në gjuhën e origjinës. Për shkak të saktësisë së dokumentacionit, ruajtja e guaskës grafike të emrit të huazuar pa ndryshime është bërë më e mprehtë dhjetëvjeçarët e fundit. Edhe në medien tonë të shkruar vihet re prirja për t'i lënë emrat e përveçëm në variantin e tyre origjinal (*Elisabeth, Thatcher, Trump, Schulz, Bill Gates, Henry*), madje pa mbaresa rasore. Një teknikë të tillë S. Hervey dhe I. Higgins e quajnë kalim automatik të emrit në formë të pandryshuar në gjuhën pritëse (Hervey & Higgins 1992, 258).

Bartja e drejtpërdrejtë e njërive antroponimike dhe toponimike është e përhapur në shumicën e vendeve europiane që përdorin alfabetin latin, ku emrat shkruhen si në gjuhën e origjinës: *Biden, Hemingway, Dumas, Molière, Rousseau, Goethe, Liszt, Puccini, Straus, Stefan Zweig, Byron, Mathew, Rzeczycki, Walter, Darwin, Freud, William, Faulkner; New York, New Orleans, Bologna, Bordeaux, Rio de Janeiro*. Kështu, p.sh., nëse përkthyesi do të duhej të transmetonte nga anglishtja në një gjuhë tjetër me alfabet latin emrin e fizikanit anglez *Isaac Newton*, do ta linte atë në gjuhën pritëse pa ndryshime, ashtu siç shkruhet fjala në origjinal *Isaac Newton* dhe jo ashtu, sikurse shqiptohet (fr. *lois d'Isaac Newton*, sp. *leyes de Isaac Newton*, it. *le leggi di Isaac Newton*). Në gjuhën shqipe do të shkruanim: ligjet e *Isaac Newton-it* duke shtuar me vizë ndarëse mbaresën rasore (por jo ligjet e *Isak Njutonit*).

Nisur nga fakti se njohja me emrin e huaj bëhet më së pari nga forma e tij shkrimore, disa gjuhëtarë shqiptarë janë të mendimit se emrat vetjakë duhen transmetuar në të njëjtën mënyrë, siç ndodh brenda vetë komunitetit evropian, pra nga një gjuhë europiane që përdor alfabetin latin, në një gjuhë tjetër që përdor po të njëjtin alfabet. Kështu, sipas traditës së ngulitur në Europë, emrat vetjakë, pavarësisht nga gjuha e përkthimit, transmetohen jo me transliterim ose transkriptim, por me kalim të thjeshtë duke ruajtur drejtshkrimin e tyre origjinal. Një kërkesë të tillë e gjejmë edhe në udhëzimet metodike të Komisionit Evropian për përkthyesit në gjuhën angleze (*English Style Guide*, 2022, 31). Studiuesi A. Vehbiu shkruan: “Në rrethanat ku shkrimi ka përparësi ndaj shqiptimit (formës së folur) në njësimin e ligjërimit publik, ka më shumë rëndësi që emrat e huaj të shkruhen drejt dhe saktë, se ç’ka që të shqiptohen mirë... Në çdo rast, pikënisja duhet të jetë njësimi i drejtshkrimit të emrit të përveçëm, jo i drejtshqiptimit të tij; tek e fundit, verba volant, por scripta manent” (Vehbiu 2020).

Është e kuptueshme se bartja e drejtpërdrejtë e emrit të huaj ka anë pozitive për praktikën përkthimore, sepse e çliron përkthyesin nga luhajat në transliterimin/ transkriptimin e emrave të huaj, nga përgjegjësia e drejtshkrimit

të tyre pa gabime, por mendimi se shqiptimi nuk është i rëndësishëm, na duket i pambështetur. Dihet se komunikimi realizohet në dy forma: gojarisht dhe grafikisht. Të dy format krijojnë një unitet kompleks dhe në praktikën ligjërimore (shkrimore ose gojore) zënë vend të rëndësishëm dhe afërsisht të barabartë. Kush nuk njeh, veç anglishtes, gjuhë të tjera europiane ose jo-europiane me alfabet latin, nuk mund të përcaktojë shqiptimin e emrit të huazuar, ngaqë këto gjuhë, kanë shkallë të ndryshme mospërputhjeje midis gjuhës së shkruar dhe gjuhës së folur. Fjala vjen, një lexues i zakonshëm, pasi ka përfunduar së lexuari një roman të përkthyer në anglisht nga gjuhë të tjera me alfabet latin, ku emrat e personazheve janë lënë si në origjinal, ai nuk është në gjendje të shqiptojë korrekt emra/mbiemra personazhesh a vendesh si: fr. *Beaudelaire*, gjerm. *Häusler*, hung. *Öttömös*, pol. *Kościuszko*, ose emra të njëjësive vendore: fr. *Bordeaux*, gjerm. *Aeschenbacher*, sp. *Albuxech*. Për më tepër, shqipja kërkon që emrat të shkruhen a shqiptohen me mbaresat rasore përkatëse, por a do të kishte kuptim të ligjërohej një paraqitje e tillë grafike, fjala vjen (po lexonte) *Beaudelaire-in*, (i telefonoi) *Öttömös-it*? Nëse do të shtrihej një rregull e tillë edhe në emrat e përveçëm të onomastikës letrare në gjuhët me alfabet të përbashkët, të paktën do të duhej që në shfaqjen e parë të emrit të jepej shqiptimi në kllapa (Bodler), (Hojlsler), (Etjomjosh), (Kostjushko); (Bordo), (Eshenbaher), (Albushek). Mendoj se në përkthimin e letërsisë artistike, e cila shkruhet për masën e gjerë të lexuesve, orientimi shqiptimor është i pashmangshëm. Shqiptimi është pjesë e kulturës së huaj, sa edhe shkrimi.

Edhe kalimi automatik (transplantimi) i emrit të përveçëm në gjuhën tjetër, që përdor të njëjtin sistem grafik me gjuhën burimore, nuk i zhduk plotësisht të gjitha problemet. P.sh. shenjat e shumta diakritike që përdoren në gjuhë të ndryshme (*á, à, ã, ä, ê, è, ë, ï, ø, ö, ü; ĝ, ž, š, ș, ç, l* etj.) janë dallime grafike më të shpeshta që e vështirësojnë bartjen pa ndryshime të emrit. Ideale do të ishte sikur të riprodhoheshin të gjitha elementet grafike të origjinalit, së bashku me shenjat diakritike, por praktika tregon se për lexuesin e gjerë diakritikët gjatë bartjes herë-herë mënjanohen. P.sh.: emrin e turqishtes *Mevlüt Çavuşoğlu* me katër shenja diakritike, diku në anglishte e gjejmë të bartur me të gjitha shenjat e diku tjetër pa to, *Mevlut Cavusoglu*.

Gjuhëtarët me të drejtë kanë vënë në dukje se edhe teknika e bartjes së drejtpërdrejtë të emrave të përveçëm nuk është universale, madje edhe kur gjuhët kanë alfabet të përbashkët. Bartja e drejtpërdrejtë e emrit të përveçëm mund dhe duhet të gjejë përdorim në përkthimet e teksteve të veçanta shkencore, në vepra enciklopedike, në fushën e teknologjisë së informacionit, në fushën e shkencës bibliografike, të cilat kërkojnë saktësi në regjistrimin emrave të përveçëm.

Duke u shkëputur nga problematika e transmetimit të emrave të përveçëm brendapërbrenda gjuhëve me sisteme alfabetike të përbashkëta, po ritheksojmë

se në përkthimet e letërsisë artistike nga rusishtja cirilike në shqip transkriptimi dhe transliterimi mbeten dy metodat kryesore për transmetimin e njësisë antroponimike e toponimike. Mendojmë se modifikimet shqiptimore të emrit të huaj nëpërmjet transkriptimit janë të pashmangshme. Praktika të tilla mund të mos jenë ideale në kuptimin që dy gjuhët nuk kanë gjithmonë përkime të plota fonetike dhe grafike, megjithatë transkriptimi praktik e zgjidh të paktën pjesërisht problemin. Siç u vu në dukje më sipër, kjo teknikë synon të transmetojë tingëllimin e emrit, por duke u larguar nga parimet rreptësisht fonetike e fonologjike dhe duke përfshirë të gjitha elementet e mundshme të transliterimit.

III. Disa gabime e pasaktësi në transmetimin e emrave të përveçëm nga rusishtja

Krahas traditës së mirë që është krijuar në transmetimin e emrave të përveçëm nga rusishtja me alfabet cirilik, në mjaft përkthime e te përkthyes të ndryshëm transmetimi i këtyre njësisë leksikore ka mbetur i hallakatur, i rrëmujshëm e me zgjidhje përkthimore të qortueshme. Gabimet, pasaktësitë dhe humbjet në përkthim kushtëzohen kryesisht nga faktorë gjuhësorë e kulturorë, nga dallimet në sistemet dhe normat e gjuhës burimore e të gjuhës pritëse, nga dallimet etnokulturore, nga tradita kulturore e nga ndonjë faktor tjetër. "... [Ç]do përdorim i një emri të huaj të përveçëm në ligjërim është pikërisht akt i komunikimit ndër-gjuhësor dhe ndërkulturor, rezultat i të cilit është ndërveprimi i dy sistemeve gjuhësore e ligjërimore, i dy traditave kulturore-psikologjike" (Ермолович 2001, 200).

Gabimet e humbjet përkthimore janë të llojllojshme, madje edhe të pashmangshme, por përkthyesi ka për detyrë t'i mënjanojë ose t'i minimizojë ato në maksimum. Po analizojmë disa shkelje të normave gjuhësore e zgjidhje përkthimore të gabuara në transmetimin e emrave të përveçëm nga gjuha ruse, të cilat u hetuan në përkthimet e realizuara gjatë 70 viteve të fundit. Më tipiket po i rendisim më poshtë:

1. Prania e dy ose më shumë varianteve përkthimore për të njëjtin antroponim ose toponim në të njëjtën vepër, tek i njëjti përkthyes ose te përkthyes të ndryshëm: *Дмитр* – *Dmitër*, *Dimitër*, *Dhimitër*, *Евгений* – *Jevgen*, *Evgen*, *Eugen*, *Eugjen*, *Егор* – *Jegor*, *Egor*, *Надежда* – *Nadezhda*, *Nadjehda*, *Ефимов* – *Jefimov*, *Efimov*, *Катя* – *Katia*, *Katja*, *Пётр* – *Pjotr*, *Pjotër*, *Pjetër*, *Алексей* – *Aleksej*, *Aleksei*, *Толстой* – *Tollstoj*, *Tolstoj*, *Tolstoi*, *Федор* – *Fedor*, *Fiodor* *Fjodor*.

Paraqitja e njësisë antroponimike në dy a më shumë variante është pakujdesi e palejueshme. Mbiemri i personazhit *Емельянов* (nga greqishtja e vjetër *lajkatar*, i këndshëm në bisedë), i përmendur nga autori 8 herë vetëm në dy faqe, është shkruar korrekt në shqip vetëm 3 herë (*Emeljanov*), ndërsa 5 herët e tjera jepet gabim (*Emiljanov*). Të dy variantet kanë të njëjtën origjinë

(nga emri kishtar *Емилиан*), por juridikisht janë mbiemra të ndryshëm. Nëse në një tekst juridik, fjala vjen, në një dokument noterial trashëgimie, ku mbiemri *Emeljanov* do të ishte shkruar edhe në formën *Emiljanov*, dokumenti do të ishte i pavlefshëm, sepse secili variant do të merrej për persona të ndryshëm.

Përkthyesi i tregimit të Çehovit “Hakmarrja” mbiemrin *Дегтярев*, të përmendur në tekst 6 herë, në të gjitha rastet e ka shkruar me tri gabime (*Degtiajev*). Gabimet lidhen me transkriptimin e grafemave **я** dhe **ѣ** që shqipes i mungojnë: e para është dhënë me **ia** (duhet me **ja**), e dyta me **je** (duhet me **jo**, sepse **e** e theksuar lexohet **jo**), ndërsa shkronja ruse **р** është harruar. Varianti korrekt i antroponimit duhet të ishte *Degtjarjov* (krahaso në angl. *Degtyaryov*).

Të njëjtën situatë kemi edhe me transmetimin e disa njërive toponimike. Toponimi rus *Заборье* haset në tri variante, asnjëri i saktë: *Zaborie*, *Zaboritje*, *Zaborije* (për *Zaborje*), *Zarjadije*, *Zarjadie* (për *Zarjadje*). Po kështu emërtimet *Белогорская* (*крепость*) dhe *Белогорский* (*монастырь*) diku është transkriptuar korrekt (kështjella) e *Bjellogorskut* e diku gabim (manastiri) i *Bellogorskët*.

2. Në disa përkthime mbaresa ruse **-уѣ** (**-ij**) tek emrat dhe mbiemrat e përveçëm të gjinisë mashkullore është ruajtur e plotë në shkelje të traditës përkthimore të ngulitur prej vitesh: *Brodskij* për *Brodski*, *Vasilij* për *Vasili*, *Jurij Dombrovskij* për *Juri Dombrovski*, *Jurij Millosllavskij* për *Juri Millosllavski*.

3. Imitimi i gabuar nga anglishtja ose nga gjuhë të tjera i transkriptimit të antroponimeve dhe toponimeve: *Liudmila* për *Ljudmilla*, *Tatiana* për *Tatjana*, *Kolia* për *Kolja*, *Pliushkin* për *Pljushkin*, *Viaçeslav* për *Vjaçesllav*, *Fiodor* për *Fjodor*; *Biellogorsk* për *Bjellogorsk*, *Briansk* për *Brjansk*.

4. Në raste më të rralla haset humbja e mbaresës së gjinisë femërore **a** dhe mbiemri i heroinës së veprës tingëllon njësoj si mbiemri i heroit letrar: (*Tatiana*) *Llosev* për (*Tatjana*) *Lloseva*, (*Emilia*) *Kabakov* për *Kabakova*, (*zonja*) *Llopuhov* për (*zonja*) *Llopuhova*. Po të respektohej një rregull e tillë, do të duhej që mbiemrat e personazheve të letërsisë ruse t'i shkruanim *Olga Семёнов*, *Natalja Rostov*, *Ana Karenin*, *Tatjana Llarin*, *Irina Prozorov*, *Katerina Kabanov*, çka do të binte në kundërshtim me drejtshkrimin e gjuhës ruse. Natyrisht, ka mbiemra që shkruhen pa mbaresën **a**, por në këto raste mbiemrat janë njësi leksikore të huazuara nga gjuhë të tjera: *Lluisa Anderson*, *Alla Bossart*, *Natalja Venkstern*, *Jelena Segal*, *Zhozefina Josifovna Millan*.

5. Prirja për të shqiptarizuar emrat e përveçëm rusë: *Aleksei* – *Aleksi*, *Георгиј* – *Gjergj/Gjorgj*, *Дмитр* – *Dhimitër*, *Кузьма* – *Kozma*. *Михаил* – *Mihal*, *Настја* – *Nasta*, *Николај* – *Nikolla*, *Ольга* – *Ollga*. Emrat e përveçëm bëjnë pjesë në grupin leksikor të realieve që mbartin ngjyrimet e theksuara kombëtare e historike. Si elemente të kulturës që i ka prodhuar nuk duhen përzier me elemente të kulturës pritëse.

6. Precedenti i emrit të shkrimtarit rus *Лев Толстой* (*Lev Tolstoi*), i përkthyer në frëngjishte si *Léon*, në italishte si *Leone* dhe i huazuar në shqipë si *Leon* (*Tolstoi*), ka shërbyer si shembull negativ imitimi. Emrat e autorëve, si rregull, nuk përkthehen, por nëse përkthyesit e frëngjishtes a italishtes e kanë parë të arsyeshme ta japin emrin rus *Лев* të përkthyer në gjuhët e tyre dhe kësaj zgjidhjeje i është bashkuar edhe përkthyesi ynë, në shqip duhet të ishte *Luan* dhe jo *Leon* (*Tolstoi*). I ngulitur gabim para 60–70 vitesh, ky emër vazhdon të përdoret edhe sot, edhe pse në përkthimet ose ripërkthimet e mëpasme të veprave të Tolstoit gabimi ka filluar të ndreqet. Imitimi jo i mirëmenduar i emrit të Tolstoit nga gjuhë të tjera nuk mund të shërbejë si model për transmetimin e rasteve të tjera, ashtu si ka ndodhur me personazhin *Лев* (*Трофимович*) në njërin nga tregimet e përmbledhjes *Tregime & Novela* të A. Çehovit, emri i të cilit është dhënë në shqip si *Leon* (*Trofimoviç*) në vend që të transliterohej si *Lev* (*Trofimoviç*). Huazimi në shqip i emrit *Leon* është tërësisht i pajustificuar; zoonimi i rusishtes *лев* përkthehet në shqip *luan* dhe jo *leon*, por edhe sikur të ishte dhënë *Luan* (*Trofimoviç*), përkthimi në shqip i emrit të personazhit do të kishte qenë i panevojshëm, sepse ai nuk ngërthen në origjinal kuptime a simbolika të tjera që ndihmojnë në zërthimin e idesë së autorit.

7. Shmangiet në përkthim ndonjëherë lidhen me përdorimin e emrit të përveçëm në origjinal si emër i përgjithshëm. Po sjellim si shembull transmetimin e emrit të personit enigmatik në historinë ruse, të ashtuquajturit *Лжедмитрий*. Emri i vërtetë i tij ishte *Юрий Богданович Отрепьев* (Juri Bogdanoviç Otrepjev), por njihet gjerësisht me pseudonimin *Dimitri i Rremë*. E mbante veten si pasardhësi i Ivan Groznit, para të huajve hiqej si perandor, madje arriti të zërë fronin perandorak rus në vitin 1605 dhe përfundoi tragjikisht pas një viti. I përmendur në romanin “Mjeshtri e Margarita” të Bullgakovit në një nga replikat midis Rimskit dhe Varenuhës për një telegram urgjent që kishin marrë nga Jalta lidhur me anulimin e një shfaqjeje teatri, pyetjes së Rimskit se ç’ishte ky person që kishte dërguar një telegram të tillë, bashkëbiseduesi i përgjigjet: – *Лжедмитрий*, – *сказал Варенуха*... Në përkthimin shqip emri është transmetuar korrekt (kalkim + transkriptim), por është vendosur gabim në trajtën e shquar: – *Dimitri i Rremë*, – *tha Varenuha*... Përgjigjja nuk ka logjikë, krijon përshtypjen e gabuar sikur telegrami ishte dërguar prej tij në vitet ’30 të shek. XX, kur u shkrua vepra, ndërkohë që *Dimitri i Rremë* u përkiste 3-4 shekujve më parë. Me përgjigjen e tij Varenuha ka dashur të thotë se telegramin e kishte shkruar një person i papërgjegjshëm, i pabesueshëm, *një Dimitër i Rremë*. Përkthyesi nuk ka mundur të harmonizojë kontekstin historik me formën gramatikore, çka ka çuar në shtrembërimin e përmbajtjes. Rusishtja nuk ka nyja për të bërë dallimin emër i shquar/emër i pashquar. Për rusishtfolësin ndërtimi i mësipërm nuk përbën problem, ai e percepton njësinë leksikore të mësipërme herë si të shquar e herë si të pashquar sipas kontekstit, ndërsa përkthyesi ynë e ka të detyruar ta njohë këtë veçori të

rusishtes (mungesën e nyjave) dhe ta pasqyrojë saktë kuptimin gramatikor të shquarsisë ose të pashquarsisë.

Lista e pasaktësisë mund të vazhdohet edhe me raste të tjera, por shembujt e sjellë janë të mjaftueshëm për të kuptuar se çfarë dëmi mund t'u sjellë nivelit të lexuesit dhe nivelit të përgjithshëm të kulturës sonë cilësia e dobët e përkthimit.

Ja disa nga shkaqet që kanë çuar në pasaktësitë e shtrembërimet e mësipërme: vëmendja e pamjaftueshme e përkthyesit ndaj dallimeve që kanë sistemet grafike të rusishtes dhe shqipes, prirja për të huazuar verbërisht transkriptime nga gjuhë të tjera, zgjidhjet e nxituara pa u thelluar në veçoritë strukturore, semantike e funksionale të njësive antroponimike e toponimike të origjinalit. Diku-diku gabimet e mësipërme flasin për mungesë profesionalizmi dhe mangësi në kulturën gjuhësore të përkthyesit. Edhe redaktimi i tekstit, si pjesë e pandashme e procesit përkthimor, në shumicën dërrmuese të rasteve i ka mbetur përkthyesit. Edhe kur formalisht redaktori i përkthimit shënohet në vepër, ai më së shumti mbetet formal.

Sjellja e një vepre të huaj letrare në kulturën dhe gjuhën tënde është veprimtari krijuese që nuk mund të kryhet nxitimthi. Si çdo krijim, ajo kërkon kohë, përqendrim, e ritëm të shtruar pune. Rendja pas fitimit nga përkthyes të rastësishëm dhe botues jo seriozë nxjerrin produkte që e zhgënjejnë lexuesin. Në vend që kultura e huaj që përzgjidhet dhe sillet në shqip për ta njohur, bën të kundërtën, i krijon lexuesit pështjellime të panevojshme. Si mund të njihet lexuesi me kulturën e huaj kur personazhin e tekstit rus me emrin e shkurtuar *Cmëna* (Stjopa - nga Stepan – emër ortodoks me burim nga greqishtja) përkthyesi e zëvendëson me emrin shqiptar *Demkë* (shkurtim i emrave të traditës myslimane *Adem* ose *Demir*), ose për shprehjen stilistikisht neutrale “*Ты всё об этом*” (*Gjithnjë të njëjtat gjëra thua*), përkthyesi përdor pa vend njësinë frazeologjike të shqipes që ka në përbërje një emër shqiptar *Ti gjithnjë këngën e Mukës*. Në rrafshin semantik njësia frazeologjike e shqipes është plotësisht barasvlerëse, por tepër e gabuar në rrafshin kulturologjik. Është e palejueshme që kulturës së huaj t'i injektojmë elemente me ngjyresa të theksuara kombëtare shqiptare të tipit *këngën (avazin) e Mukës, opingat e Sheros, si ëma e Zeqos majë thanës, si Xhaferi simiten, si në kohën e Baba Qemos* etj. Përfshirja e këtyre emrave myslimanë në përkthim shpie në nivelim fetar, emrat e traditës ortodokse të origjinalit zëvendësohen me emra të traditës myslimane. Edhe në përkthimin e anasjelltë (shqip-rusisht) shprehja frazeologjike e shqipes, p.sh. *në kohën e Baba Qemos* nuk mund të zëvendësohet me shprehjen ruse *нпу царе Горохе* (në kohën e carit Goroh). Përkthimi i frazës *Kjo ishte në kohën e Baba Qemos, ndërsa ti e kujton sot* nuk mund të jetë *Это ну царе Горохе было, а ты вспоминаешь сегодня*, sepse personazhet e njësive frazeologjike *Baba Qemoja* në shqipe dhe *cari Goroh* në rusishte janë produkte të dy kulturave të ndryshme me ngjyrimet e forta

historike që nuk mund të zënë vendin e njëri-tjetrit në to. Variant i pranueshëm përkthimor do të ishte zëvendësimi i komponentit emëror të shqipes me shprehje neutrale të rusishtes, p.sh. *Это было давно, а ты вспоминаешь сегодня*. (Kjo ka qenë qëmoti, ndërsa ti e kujton sot).

Shtrembërimet e pasaktësitë e mësipërme nuk janë të vetmet. Po t'u shtojmë atyre edhe shumë raste të tjera ku mjedisi e kultura ruse shqiptarizohen në mënyrë të palejueshme, niveli i përkthimit do të cenohet seriozisht. Kur lexon frazën “*beu ua shtroi fshatarëve me verë e raki*”, të krijohet përshtypja sikur ngjarja zhvillohet në një mjedis shqiptar, sepse elementet *beu* e *rakia* i përkasin kulturës sonë. Në fakt kemi të bëjmë me një përkthim aspak profesional nga rusishtja. Teksti në origjinal është ndryshe: *zotëria ua shtroi muzhikëve me verë e vodkë*. Një përkthim i tillë nuk rrafshon veçoritë kombëtare të origjinalit me ato të shqipes, nuk e kalon lexuesin nga njëra kulturë në tjetrën. Në ndonjë rast tjetër të duket sikur autori i veprës ka shkruar për lexuesin shqiptar. Kështu, në novelën “Kazakët” duket sikur Lev Tolstoi zotëron të folmen e zonës së përkthyeses sonë: - *Ç’u ngrystë, motëro, i bëtë punët?... – Po qysh e ke tët shoq, motëro?* Për t’u njohur me kulturën e huaj, shqipfolësi duhet të lexojë Tolstoin rus dhe jo përkthyesen tonë. Është rasti këtu të sjellim në vëmendje vërejtjen që i ka bërë shkrimtari J. Brodski përkthyeses angleze të letërsisë klasike ruse Constance Garnett: “Arsyeja që lexuesit anglishtfolës zor se mund të shpjegojnë ndryshimin midis Tolstoit dhe Dostojevskit është se ata nuk lexojnë prozën e të parit dhe të dytit. Ata lexojnë Constance Garnett-in”. (Красавченко. 2019, 41-45)

Janë të njohura në literaturën përkthimore strategjitë e “forenizimit” dhe “domestikimit” të elementeve kulturologjike specifike, ku bëjnë pjesë dhe emrat e përveçëm. Priorja për zëvendësimin leksiko-semantik të kulturionimit edhe në rastet kur nuk është i domosdoshëm (fjala vjen *i zotërisë me beun*, *i vodkës me rakinë*) shpie në domestikimin e tekstit, në përshtatjen e pamotivuar të kulturës së huaj për lexuesin shqiptar, ashtu sikundër ruajtja e sforcuar e kulturionimit të huaj (me anë të transliterimit ose transkriptimit) çon në forenizimin e elementeve kulturore, vështirësisht të kuptueshme ose tërësisht të pakuptueshme për lexuesin e përkthimit, p.sh. *Отдыхали в Ульяновске – в городе на Венеце*. Varianti *Pushuam në Uljanovsk, në qytetin Venec* do të ishte një transkriptim i pakuptueshëm i toponimit **Vенец**. Variant i pranueshëm në shqip do të ishte përkthimi dhe përshtatja e toponimit: *Pushuam në Uljanovsk, në qytetin e maleve Kurorë*. Strategjia e afrimit të lexuesit të përkthimit të kultura e huaj teorikisht është më e mbështetur,

Shpërftyryrimi i kulturës së huaj ul ndjeshëm nivelin e përkthimit. Ndoshta, në një të ardhme jo të largët produktet përkthimore të paarrira do t’i nxjerrë jashtë loje përkthimi kompjuterik dhe vendin e përkthyesit do ta zërë redaktori profesionist, i kualifikuar e me përvojë, i cili do të punojë mbi tekstin kompjuterik.

Situata e përkthimeve tona rëndohet edhe nga disa rekomandime a rregulla herë-herë kontradiktore, të vendosura në “Drejtshkrimin e gjuhës shqipe” (Tiranë 1973), apo në materiale të tjera për Kongresin të Drejtshkrimit, p.sh. diku sugjerohet *Turgeniev* e diku *Turgenjev*, diku *Nikolaj* e diku *Jermollaj*. Rrallëkush mund të shkruajë a shqiptojë *Ludmila* (për Ludmilla), *Lukashenko* (për *Llukashenko*), *Lukan* (për *Llukan*), *Slavka* (për *Sllavka*). Një kufizim i tillë shqiptimor e drejtshkrimor na duket i pambështetur, sepse shqipes nuk i mungon fonema *ll*.

IV. Disa qasje e rekomandime për mënjanimin a minimizimin e gabimeve

1. Po e fillojmë me fonemën e rusishtes *л*, së cilës i përkon *ll*-ja e shqipes, por paraqitja grafike e saj në përkthimet tona të hershme dhe të sotme ka mbetur shumë e paqëndrueshme. Në “Drejtshkrimin e gjuhës shqipe” (§ 37, shënimi 1) është përcaktuar se emrat e përveçëm të gjuhëve sllave, pavarësisht nga mënyra e shqiptimit të *l*-së në këto gjuhë, shkruhen përgjithësisht me *l*: *Lomonosov*, *Ludmila*, *Volodja*, *Bajkal*, *Bratislava*, *Jalta*, *Ladoga*, *Ural*, *Vladivostok* etj. Mendohet se emrat që ilustrjnë rregullën e mësipërme kanë hyrë fillimisht në gjuhën shqipe me fonetikën e gjuhëve perëndimore, ku mungon fonema *ll*. Te Fjalori Drejtshkrimor është bërë përjashtim për emrin *Vollga*, në pajtim me formën tashmë të ngulitur në shqip, rrjedhimisht edhe për *Vollgograd*, por si do të shkruhen fjalëformimet e pangulitura *Приволжье* (qendër administrative e rajonit të Samarës), *Поволжье* (rajon në pjesën europiane të Rusisë)?

Kërkesa e mësipërme e shënimit 1 të § 37 në përkthimet e shqyrtuara, diku është respektuar (*Lolita*, *Luiza*, *Lzhedimitri*, *Mihail*, *Vjaçeslav*, *Vladimir*), por në pjesën dërrmuese të rasteve jo: *Bullgakov*, *Dovllatov*, *Zabollocki*, *Feklla*, *Hlllopov*, *Ludmilla*, *Llaptjev*, *Llarisa*, *Llopuhova*, *Lloshadin*, *Llotman*, *Lluka Llukiç*, *Millosllavski*, *Sllavka*, *Sollzhenicin*, *Stanisllav*, *Shollohov*. Ka raste kur emri është shkruar me *l*, ndërsa atësia ose mbiemri me *ll*: *Larisa Nikollajevna*, *Mihail Bullgakov*, *Mihail Shollohov*, *Vladislav Illarionoviç*, *Vladimir Mihajlloviç*. Kjo gjendje paqëndrueshmërie vihet re si në përkthimet e para të letërsisë ruse, të realizuara nga përkthyes që zotëronin gjuhë perëndimore (frëngjisht, italisht), ashtu edhe pas Kongresit të Drejtshkrimit që sanksionoi shkrimin e *л*- së me *l*.

Formulimi i këtij shënimi bie ndesh me parimin e përgjithshëm “Shkrimi i emrave të përveçëm të huaj mbështetet përgjithësisht në shqiptimin e tyre në gjuhët përkatëse, duke ia përshtatur sistemit grafik të shqipes” (§ 37). Së pari, shqipes nuk i mungon fonema *ll*; së dyti, formulimi i kësaj rregulle është pasojë jo e ndonjë faktori të brendshëm gjuhësor midis shqipes dhe rusishtes, por e ndikimit nga jashtë, nga gjuhë të tjera; së treti, zëvendësimi i *л*-së ruse me *l* të shqipes, përveç se është një lloj gjymtimi fonetik dhe grafik, është edhe një lloj

“kurthi” për përkthyesin: ai shqipton e shkruan fjalën ruse *sllav* (vend *sllav*, popull *sllav*, *gjuhë sllave*), ndërsa antroponimet e toponimet *Millosllavski*, *Sllavka*, *Stanisllav*, *Vjaçesllav* duhet t’i shqiptojë e shkruaj *Miloslavski*, *Slavka*, *Stanislav*, *Vjaçeslav*, *Vladislav*. Për toponimin *Bjellorusi* (tani *Republika Bjellorus*) është bërë përrjashtim, por si duhen shkruar antroponimet a toponimet e tjera që fillojnë me pjesën *bjell-/бел-: Bjellgorod ose Bjelgorod, Bjellogorsk ose Bjelogorsk; Bjellousov ose Bjelousov, Bjelloshapkova ose Bjeloshapkova?* Mishmashi i krijuar mund të mënjanohet me zhbërjen e rregullës për fonemën *ll*. Përrjashtimet e pranuar të tipit *Vollga, Vollgograd, Bjellorusi* ilustronë parimin e përgjithshëm, ndërsa emrat tashmë të ngulitur *Lomonosov, Tolstoi, Vladimir; Bajkal, Jalta, Ural, Vladivostok* etj. mund të përfshihen si përrjashtime.

2. Emrat dhe mbiemrat e gjinisë mashkullore që mbarojnë në fund me *-ий/-ый (-ij)* shkruhen në shqip me *-i*: *Анатолий – Anatoli, Андреевский – Andrejevski, Аркадий – Arkadi, (Демьян) Бедный – (Demjan) Bjedni, Белинский – Bjelinski, (Андрей) Белый – (Andrei) Bjelli, Богомольный – Bogomolni, Василий – Vasili, Виталий – Vitali, Валерий – Valeri, Вяземский – Vjazemski, Геннадий – Genadi, Георгий – Georgi, Горький – Gorki, Григорий – Grigori, Достоевский – Dostojevski, Жуковский – Zhukovski, Игнатий – Ignati, Навальный – Navalni, Островский – Ostrovski, Паустовский – Paustovski, Сергей – Sergi, Чайковский – Çajkovski, Чуковский – Çukovski, Юрий – Juri*. Kjo është tashmë një traditë e ngulitur, e sanksionuar edhe nga rregullat e drejtshkrimit të shqipes (§ 37 shënim 2).

Shkrimi i emrave të mësipërm me *-ij* duhet mënjano, sepse, së pari, në gjuhën shqipe bashkëtingëllorja *j* në grupin *ij* dëgjohet dobët; së dyti, prania e saj në format e tjera rasore vështirëson leximin e *emrit*: (biseda me *Vitalijin*, tregimet e *Gorkijit*). Ja një shembull i transmetimit aspak të përshtatshëm i mbiemrit të personazhit *Римский* nga përkthyesi i dytë i romanit të Bullgakovit “Mjeshtri dhe Margarita”: *Не выдержали нервы, как говорится, и Римский... бежал в свой кабинет. Римскийни*, si i thonë, s’e mbajtën nervat, por rendi në zyrën e tij,..(f. 225).

3. Emrat/mbiemrat mashkulorë me *-ий* fundore, së cilës i paraprijnë zanoret *-а (-ай), -о (-ой), -е (-ей)* shkruhen me *-i* si emrat e pikës 2 me *-ий*: *Алексей – Aleksej, Андрей – Andrej, Корней – Kornej, Матвей – Matvej, Николай – Nikollai, Полевой – Polevoi, Толстой – Tolstoi, Сергей, – Sergei; Валдай – Vall dai, Енисей – Jenisei*.

Grupet *-ай, -ой, -ей* në trup të fjalës jepen me *aj, oj, ej*: *Байкал – Bajkal, Войнович – Vojnoviç, Пантелеймон – Pantelejmon*. Edhe kjo është tashmë një traditë e ngulitur, e sanksionuar nga rregullat e drejtshkrimit të shqipes (§ 36 c).

4. Emrat femërorë që mbarojnë me *-ия* duhen shkruar shqip me *-ia*: *Анастасия – Anastasia, Валерия – Valeria, Ксения – Ksenia, Лидия – Lidia, Мария – Maria, Наталия – Natalia*.

5. Emrat femërorë që mbarojnë me **-ья** ose **-я** shkruhen me **-ja**: *Авдотья* – *Avdotja*, *Анисья* – *Anisja*, *Ася* – *Asja*, *Дарья* – *Darja*, *Марья* – *Marja*, *Наталья* – *Natalja*, *Настасья* – *Nastasja*, *Олеся* – *Olesja*, *Оля* – *Olja*, *Прасковья* – *Praskovja*, *Софья* – *Sofja*, *Таня* – *Tanja*, *Юля* – *Julja*.

Kjo rregull vlen edhe për format e shkurtra zvogëluese nga emrat mashkullorë: *Ваня* – *Vanja*, *Вася* – *Vasja*, *Витя* – *Vitja*, *Митя* – *Mitja*.

Shënim: Antroponimet e tipit *Наталия* dhe *Наталья* kanë prejardhje të njëjtë, por juridikisht janë emra të ndryshëm, prandaj transmetimi i tyre në përkthim duhet ta pasqyrojë këtë dallim. Është kjo arsyeja që në Rusi janë formuluar rregulla të reja për pasqyrimin e këtij dallimi në transliterimin e emrave rusë me shkronja latine (vetëm për pasaportat për jashtë shtetit, patentat e drejtimit të automjeteve dhe kartat bankare). Transliterimi është standardizuar si më poshtë: *Анастасия* – *Anastasiia* dhe *Анастасья* – *Anastasia*, *Ксения* – *Kseniia* dhe *Ксения* – *Ksenia*, *Мария* – *Mariia* dhe *Марья* – *Maria*, *Наталия* – *Nataliia* dhe *Наталья* – *Natalia*.

6. Emrat/mbiemrat që kanë grafemën **я** shkruhen në shqip me **ja**, parvarësisht nga pozicioni i saj në fjalë: *Яким Овсянников* – *Jakim Ovsjanikov*, *Яна Шалапина* – *Jana Shaljarina*, *Вячеслав Стоянов* – *Vjaçesllav Stojanov*, *Зоя Ярёмченко* – *Zoja Jarjomçenko*, *Женя Мерзлякова* – *Zhenja Merzljakova*, *Наталья Добросельская* – *Natalja Dobroselskaja*, *Рябин Чистяков* – *Rjabin Çistjakov*, *Коля Касьянов* – *Kolja Kasjanov*, *Костя Худяков* – *Kostja Hudjakov*, *Наталия Третьякова* – *Natalia Tretjakova*, *Святослав Лукьянов* – *Svjatosllav Llukjanov*, *Татьяна Звягина* – *Tatjana Zvjagina*.

Shënim: Variantet me **ia**, si *Колia* për *Kolja*, *Tania* për *Tanja*, *Viaçeslav* për *Vjaçeslav*, që hasen në përkthime të ndryshme, duhen mënjeluar.

7. Grafema ruse **ѣ** jepet në shqip me **jo**: *Алёна Ёжкина* – *Aljona Jozhkina*, *Алёша Воробьев* – *Aljoshа Vorobjov*, *Артём Ефимов* – *Artjom Jefimov*, *Вася Тёркин* – *Vasja Tjorkin*, *Дмитрий Тёмкин* – *Dimitri Tjomkin*, *Матрёна Берёзова* – *Matrjona Berjozova*, *Пётр Гринёв* – *Pjotër Grinjov*, *Пётр Тёшкин* – *Pjotër Tjoshkin*, *Семён Муравёв* – *Semjon Muravjov*, *Стёпа Ёжиков* – *Stjopa Jozhikov*, *Фёдор Семёнович Жухарёв* – *Fjodor Semjonoviç Zhiharjov*.

Duhet mënjeluar shkrimi me **io** si ndikim nga përkthimet në gjuhë të tjera që s'kanë **j** dhe në vend të saj shkruajnë **i**: *Lionka*, *Tiomkin*, *Alioshin*, *Piotër*, *Semion*, *Tioshkin*, *Beriozova*, *Fiodor* etj.

Shënim 1: Do të shkruajmë **o** pas bashkëtingëlloreve **ч, ш, щ, ж**: *Горбачёв* – *Gorbaçov*, *Лухачёв* – *Lihaçov*, *Тимашёв* – *Timashov*, *Борщёв* – *Borshçov* *Стрижёв* – *Strizhov*.

Shënim 2: Në tekstet ku shkronjës **ѣ** (jo) nuk i janë vendosur sipër dy pikat, përkthyesi duhet të bindet, nëse zanorja është e theksuar ose e patheksuar. Kur mbi të bie theksi, ajo duhet transkriptuar në shqip si **jo**, në rastet e tjera si **e**: *Золотаре'в* – *Zollotarjov*, por *Золота'рев* – *Zollotarev*,

Розале'ов – *Rogal'ov*, por *Роза'лев* – *Rogalev*. Varianti korrekt i toponimit *Бородаче'ва улица* është *rruga Borodaçova* dhe jo *rruga Borodaçeva*. Shqiptimi i lëkundur i emrit të qytetit *Orel/Orjoll* (nga emri i shpendit *орёл* - shqiponjë) me vendim të autoriteteve vendore të qytetit është sanksionuar të shkruhet me *ë* (jo) *Орël*, prandaj në shqip do të shkruajmë *Orjoll* dhe jo *Orel*, siç është sanksionuar në Fjalorin Drejtshkrimor. Po kështu emri i shkurtuar *Стена* me *e* (jo) nën theks, por pa dy pikat sipër, do të shkruhet e lexohet *Stjopa* e jo *Stepa*, siç është shkruar gabim në shumë vepra të përkthyer. Një gabim i tillë flet për lexim jo korrekt të emrit nga përkthyesi.

7. Grafema ruse *e* jepet në shqip me *je*: *Евдоким* – *Jevdokim*, *Ежов* – *Jezhov*, *Ельцин* – *Jelcin*, —*Ермилов* – *Jermillov*, *Ермаков* – *Jermakov*, *Белослав* – *Bjelloslav*, *Васильев* – *Vasiljev*, *Григорьев* – *Grigorjev*, *Надежда* – *Nadjezhda*.

Shënim 1: Shkrimi i *e*-së (*je*-së) në fillim të fjalës ka mbetur i lëkundur, krahaso: *Евгений* - *Jevgen/Evgen/Eugen/Eugjen*, *Евтушенко* - *Jevtushenko/Evtushenko*, *Егор* - *Jegor/Egor*, *Екатерина* - *Jekaterina/Ekaterina*, *Елена* – *Jelena/Elena*, *Ермаков* - *Jermakov/Ernikov*, *Ермолай* - *Jermollai/Ermoillai*, *Еремеев* - *Jeremejev/Ermejev*, *Есенин* - *Jesenin/Esenin*.

Si rregull, emrat/mbiemrat rusë të njerëzve që fillojnë me **E (Je)**, edhe kur nuk janë të fondit rus, por të huazuar nga gjuhë të tjera, duhen shkruar në përputhje me fonetikën e rusishtes, sepse prej shekujsh janë bërë pjesë e asaj kulture: *Jelena*, *Jekaterina*, *Jefimoviç*, *Jevtushenko*, *Jevgeni*. Shqiptarizimi i tingëllimit të këtyre emrave në përkthim si *Elena*, *Ekaterina*, *Eugjen* është i panevojshëm. Në letërsinë ruse ndeshen edhe personazhe me emrin *Катерина*, i cili në përkthim mbetet po me atë formë grafike *Katerina*, ndërsa *Екатерина* do të shkruhet e rusifikuar *Jekaterina*.

Shënim 2: Do të shkruajmë *e* shqip pas bashkëtingëlloreve në trup të fjalës: *Алексей Мамашев* – *Aleksei Matashev*, *Валерий Леденёв* – *Valeri Ledenjov*, *Викентий* – *Vikenti*, *Геннадий* - *Genadi*, *Дементий* – *Dementi*, *Демьян* – *Demjan*, *Женя* – *Zhenja*, *Зайцев* – *Zajcev*, *Мальцев* – *Malcev*, *Марченко* – *Marçenko*, *Ожегов* – *Ozhegov*, *Олеся* – *Olesja*, *Сергей* – *Sergei*, *Старцева* – *Starceva*, *Стручев* – *Strucev*, *Чехов* – *Çehov*, *Щебякина* – *Shçebjakina*.

Shënim 3: Kur grafema ruse *e* (je) vjen pas shenjës zbutëse (*-b-*) në trup të fjalës, jepet me *je* dhe jo me *ie*, siç rekomandohet në materialet e Kongresit të Drejtshkrimit (Lloshi 1973, 291). Shenja zbutëse **ь** në rusishte shkruhet pas bashkëtingëlloreve që ndiqen nga zanoret *e*, *ë*, *ю*, *я* dhe ka si funksion të “ndajë” shqiptimin e bashkëtingëllores dhe zanores pas saj, sikur të shqiptoheshin ndarazi nga njëra-tjetra. Për të mos e ndërlikuar pasqyrimin grafik të këtij dallimi të vogël shqiptimor propozojmë të rrafshohet shkrimi i *be*-së me të gjitha rastet e tjera të ngjashme më *бѐ*, *бя*, *бю*, të cilat në rregullën e mësipërme nuk ceken: *Афанасьев* – *Afanasjev*, (*Дмитрий*) *Анатольевич* –

(Dimitri) Anatoljeviç, (Андрей) Васильев – (Andrei) Vasiljev, (Елена) Евгеньевна – (Jelena) Jevgenjevna, Игнатьев – Ignatjev, Леонтьев – Leontjev, Прокофьев – Prokofjev. Krahaso emrat/mbiemrat e tipit Воробьев – Vorobjov, Соловьев – Sollovjov; Демьян – Demjan, Марьяна – Marjana, Татьяна Терентьева – Tatjana Terentjeva, Ульянов – Uljanov; Вьюкова – Vjukova, Льюсин – Ljusin. Shkrimi me **ie**: Vasiliev, Prokofiev, Anatolievic, Vorobiov, Demian, Ulianov, Viukova duhet shmangur.

Shënim 4. Ka raste kur *e-ja* lexohet nga përkthyesi jo korrekt si *ë-jo* dhe emri transkriptohet gabim me **o**, p.sh.: —*Вы из какой губернии?* —... *Из Черниговской.* — *Nga cila gubernë jeni?* —... *Nga Çornigovi.* Duhet shkruar Çernigovi dhe jo Çornigovi, ashtu sikurse shkruajmë emra të tjerë vendesh: *Черновци* (Черновцы), *Черняковский* (Черняковский), *Чернышевск* (Чернышевск) ose mbiemra njerëzish: *Черненко* (Черненко), *Черняк* (Черняк), *Черняков* (Черняков).

8. Emrat/mbiemrat që kanë grafemën **ю** shkruhen në shqip me **ju**: Юрий – Juri, Юдин – Judin, Ильюшин – Iljushin, Крючкова – Krjuçkova, Плюшкин – Pljushkin, Рюмин – Rjumin, Хахрюков – Hahrjukov, Юлия Тюрина – Julia Tjurina. Varianti i transkriptimit të **ю**-së ruse me **iu** shqipe (Liudmila, Iliushina, Kriuçkova, Pliushkin, Riumin, Nahriukov), i huazuar nga gjuhët perëndimore, duhet mënjeluar, sepse nuk pajtohet me fonetikën e shqipes.

9. Shqiptimi i **x** ruse është i ndryshëm nga **h** e shqipes, por kjo është fonema më e afërt me të, prandaj do të shkruajmë Архип Харитонович – Arhip Haritonoviç, Дмитрий Разумихин – Dimitri Razumihin, Миха Харченко – Miha Harçenko, Михаил Захаров – Mihail Zaharov, Прохор Хомяков – Prohor Homjakov, Тихон Хренников – Tihon Hrenikov.

Varianti i zëvendësimit të fonemës së shqipes **h** (e përafërt me **x** e rusishtes) me transkriptime të huazuara nga gjuhët perëndimore **kh** (*Kharçenko*, *Mikhail*; *Astrakhan*) duhet mënjeluar, sepse nuk pajtohet me fonetikën e shqipes. Përdorimi i formave të tilla do t'i ngjante një sallate të përzier me disa përbërës: emri/mbiemri i përveçëm rus, transkriptimi anglisht, gjuha e përkthimit shqip.

Shënim: Sipas një tradite të ngulitur disa emra anglezë ose gjermanë që fillojnë me rrokjen **her-** *Herbert*, *Hermione*, *Hermann* etj. janë transkriptuar në gjuhën ruse me zëvendësim të **x** me **z**: *Герберт*, *Гермиона*, *Герман*. Në përkthimet shqip këta emra duhen huazuar drejtpërsëdrejti nga anglishtja ose gjermanishtja, por jo të përfshihen në tekstin shqip të transkriptuar nga rusishtja. Po kështu duhet vepruar edhe me emra të tjerë ku shkronja e alfabetit latin **h** është zëvendësuar në rusishte me **z**: *Hans* – Ганс, *Hermes* – Гермес; *Havana* – Гавана, *Нагэ* – Гаага, *Copenhagen* – Копенгаген, *Hamburg* – Гамбург. Emri mitologjik i personazhit të Bullgakovit në romanin “Mjeshtri dhe Margarita”, i shkruar në rusishte *Ком Бегемот* duhej dhënë në shqip me **h** *Kot Behemot* (Maçoku Behemot) dhe jo *Kot-Begemot*.

10. Emrat/mbiemrat me grafemën e alfabetit rus **ш** në përkthimet shqip jepen me togun **shç**: *Щедрин* – *Shçedrin*, *Щербakov* – *Shçerbakov*, *Гуцин* – *Gushçin*, *Зоценко* – *Zoshçenko*, *Слащев* – *Sllashçov*, *Суцёв* – *Sushçov*, edhe pse në materialet e Kongresit të Drejtshkrimimit **ш**-në në ndonjë rast e gjejmë të zëvendësuar me shkronjën **sh**: *Хрущёв* – *Hrushov* (Lloshi 1973, 291). Një zgjidhje e tillë, ndoshta, është bërë për lehtësi shqiptimi, por në përkthimet shqip ka fituar imitimi i transkriptimit nga anglishtja me **shch** (*Shcherbakov*, *Shchalkina*, *Khrushchev*). Gjithsesi varianti shqip *Hrushov* është ngulitur dhe ka përparësi ndaj formës së mësipërme të transkriptimit.

11. Ndodh rëndom që në veprën letrare autori të përdorë për të njëjtin personazh disa variante të emrit, p.sh. te novela “Vajza e kapitenit” e Pushkinin personazhi kryesor *Pjotër Andrejeviç Grinjob*, në varësi nga situata, quhet herë *Petrusha*, herë *Pjotër Andrejeviç*, herë *Pjotër Andreiç* e herë *Grinjob*. Në këto raste është e vështirë që të përcillen në përkthim të gjitha nuancat e përdorimit të këtyre varianteve duke ruajtur njëherazi informacionin e plotë që përmbajnë temat e fjalës dhe ndajshitesat apo kombinimet e tyre. Për të mos e çorientuar lexuesin, si rregull, përkthyesi zgjedh ose variantin e përdorur më shpesh (*Pjotër Andrejeviç*), ose variantin zyrtar (*Grinjob*). Po kështu veprohet edhe në rastet kur hasim në origjinal më shumë se dy forma zvogëluese të emrave (*Masha*, *Marusja*, *Marijka*, *Mashulja* – nga *Maria*; *Borja*, *Borka*, *Boreçka*, *Borjushka* – nga *Boris*). Për të shmangur rrezikun e perceptimit të tyre si emra të ndryshëm, përkthyesi mund të përfshijë në tekstin e përkthimit vetëm njërën formë (përkëdhelëse ose përbuzëse).

12. Emrat e përveçëm të njerëzve dhe të vendeve kanë historinë e tyre. Shumë prej tyre, duke kaluar nga njëra gjuhë në tjetrën, kanë marrë ngjyrimet kuptimore e veshje tingullore të ndryshme dhe janë bërë pjesë e kulturës së njerit apo tjetrit vend. Emrin rus *Николай* (Nikollaj) me origjinë nga greqishtja (Νικόλαος) e gjejmë edhe si *Николайка*, *Николаха*, *Николаша*, *Николка*, *Николя*, *Коля*, *Колюша* e variante të tjera. Po ky emër në anglishte tingëllon *Nicholas*, *Colin*, *Collin*, *Nickolas*, *Nikolas*, në gjermanishte *Nikolaus*, *Claus*, *Klaus*, *Nickolaus*, *Nicolaus*, në spanjishte *Nicolás*, *Nicolao*, në shqip *Nikolla*, *Nikollaq*, *Nikë*, *Kolë*, *Koli* e kështu me radhë. Këto variante mund të jenë edhe emra të njerëzve të ndryshëm, por kur përdoren në një vepër letrare ato zakonisht emërtojnë të njëjtin person dhe dallojnë nga nuancat kuptimore e veçoritë fonetike.

E rëndësishme për praktikën përkthimore është që transkriptimi i variantit të përdorur në origjinal të ruajë në maksimumin e mundshëm ngjyrimet e fituara dhe origjinalitetin kombëtar. Është i palejueshëm rrafshimi i tyre me variante të përshtatura në gjuhën shqipe. P.sh. emrat realë ose bashkëkohorë *Андрей*, *Афанасия*, *Георгий*, *Елена*, *Кузьма*, *Михаил*, *Пётр* duhet të mbeten emra rusë në përkthim, natyrisht, duke bërë transkriptimet e nevojshme: *Andrei*, *Afanasia*, *Georgi*, *Jelena*, *Kuzma*, *Mihaill*, *Pjotër*, por pa i

shqiptarizuar në *Andrea, Athanasia, Gjergj/Gjeorgj, Elena, Kozma, Mihal, Pjetër*, edhe pse janë shumë të ngjashëm. Po kështu emri i carit rus *Николай I* në shqip do të mbetet car *Nikollai I* dhe jo car *Nikolla I* ose emri i carit të parë nga dinastia e Romanovëve, *Михаил Романов* (Mihail Romanov), apo emri i shkrimtarit të romanit “Doni i qetë”, *Михаил Шолохов*, (Mihail Shollohov) nuk mund të shqiptarizohen në *Mihal Romanov* e *Mihal Shollohov*, ashtu sikundër nuk mund të rusifikohet në përkthimin nga shqipja emri i patriotit dhe shkrimtarit shqiptar *Mihal Grameno* në *Михаил Грамено*. Përkthyesi i tregimeve të Çehovit ka bërë zgjidhje përkthimore të gabuar kur ka zëvendësuar *Николаевская церковь* me *kisha e Shënkollit*. Emrat *Николай/ Николаев* në rusisht dhe *Kolli/Nikolli* janë të ngjashëm, por “jetojnë” në kultura të ndryshme, madje mund t’u përkasin edhe feve të ndryshme, ortodokse ose katolike. Emrat shqip *Nikolla, Gjergji, Dhimitri* do të mbeten në rusisht të tillë ose përafërsisht të tillë: *Милош Дьердь Никола, Дьердь Фишта, Димитр Шутеричи* (fjala është jo për etimologjinë, por për funksionimin e tyre në gjuhën e sotme shqipe). Shqiptarizimi ose rusifikimi i emrave/mbiemrave ua humbet ngjyresën kombëtare. Përjashtim bëjnë emrat e disa figurave të njohura historike tashmë të ngulitur, në shqip: *Пётр Великий – Pjetri i Madh* (jo Pjotri i Madh, jo edhe Pjetërburg, i lidhur me këtë emër), në rusisht: *Гьегьг Кастриоти – Георгий Кастриоти* (jo Дьердь Кастриоти).

13. Problem përkthimor mbetet edhe transmetimi i emrave të përveçëm të huazuar në gjuhën ruse nga gjuhë të tjera, veçanërisht transmetimi i emrave të mbretërve, monarkëve dhe të disa personazheve historike. Jo rrallë në gjuhën ruse mund të gjenden dy-tri variante për të njëjtin emër të përveçëm të anglishtes. P.sh. për emrin *William* në tekste të ndryshme ruse gjejmë *Вильям* dhe *Уильям*, madje dhe *Вильгельм* (kur bëhet fjalë për *William the Conqueror* (*Вильгельм Завоеватель – Vilhelm Pushtuesi*). Varianti *Вильям* në gjuhën ruse i përket periudhës para shek. XX, kur emrat anglezë në atë gjuhë vetëm transliteroheshin, ndërsa varianti rus *Уильям* është transkriptim fonetik i origjinalit *William*. Nuk do të ishte zgjidhje e duhur, nëse përkthyesi ynë do të kalonte në shqip transkriptimin e rusishtes *Uiljam*. Në këtë rast transkriptimi duhet bërë nga gjuha burimore (anglishtja) *Uiliam*. Emri tjetër *Вильгельм Завоеватель* është i ngulitur historikisht në atë formë, e cila duhet të ruhet edhe në shqip si *Vilhelm Pushtuesi* (krahaso: fr. *Guillaume le Conquérant*, it. *Guiglielmo il Conquistatore*, gjerm. *Wilhelm der Eroberer*).

Po sjellim edhe disa raste të tjera të ngjashme: për emrin anglez *Charles* në gjuhën ruse gjejmë variantin *Карл* (Karl), nëse i përket mbretërve të dinastisë Stuart dhe *Чарльз* (Çarlz) pas kurorëzimit mbret i Anglisë. Duhet vënë në dukje se në Rusi përkthimet nga anglishtja u shfaqën më vonë, sesa nga frëngjishtja dhe gjermanishtja. Prej këtej u ngulit edhe tradita e “gjermanizimit” të emrave të huaj, p.sh. *Генрих*, jo *Анри* (Henri), *Карл*, jo *Шарль* (Charles), *Людовик*, jo *Луи* (Louis). Mbreti i fundit i Francës njihet në

rusishte si *Луи-Филипп*, jo si *Людовик-Филипп*. Prirja e “gjermanizimit” është zbatuar vetëm kur bëhej fjalë për sundimtarin në fuqi, p.sh. për mbretin *Людовик XVI* (Louis XVI), por nëse bëhej fjalë për vëllain e mbretit, kontin *Артуа*, emri i tij shkruhej *Шарль д'Артуа*. Edhe në traditën tonë mbretërit quhen *Luigj* deri te *Luigji XVI* (sipas italishtes Luigi), më pas *Lui* (Lui Filipi dhe gjithë Lui-të e tjerë).

Për transmetimin e saktë të rasteve të tilla përkthyesi duhet të bëjë paraprakisht analizën kulturologjike të njësisë antroponimike. Edhe në rastet kur vepra përkthehet nga gjuha ruse, orientues kryesor duhet të jetë gjuha burimore, nga e cila është huazuar njësia antroponimike dhe jo rusishtja, p.sh. për variantin rus *Святой Варфоломей* në shqip është futur varianti european *Shën Bartolomeu* (krahaso: angl. *St. Bartholomew*, gjerm. *St. Bartholomäus*, it. *San Bartolomeo*), ose *Henrih Hajne* dhe jo *Genrih Gejne* si në rusishte (Генрих Гейне).

14. Në varësi nga konteksti, përkthyesi mund t'i transmetojë njësitë antroponimike të përbëra nga dy fjalë, pjesërisht me kalkim dhe pjesërisht me transkriptim. P.sh. tek emri i carit rus *Иван Грозный* (*Ivani i Tmerrshëm*) pjesa e parë është transliteruar, ndërsa mbiemri (nofka) është kalkuar. Ky emër është ngulitur i tillë edhe në gjuhë të tjera (angl. *Ivan the Terrible*, fr. *Ivan le Terrible*), megjithëse nofkës *i tmerrshëm* në rusishte i përkon fjala *страшный*, jo *грозный*.

V. Antroponimet e trilluara dhe veçoritë e transmetimit të tyre në përkthim

Problem i vështirë për përkthyesin mbeten antroponimet e krijuara nga vetë autori, të cilat ai i vesh me një semantikë të caktuar dhe i përdor për të theksuar tipare të veçanta të karakterit të personazheve, por edhe si mjet për zbërthimin e idesë së veprës. Ja disa emra/mbiemra personazhesh që kanë domethënie: *Акакий* – *Akaki* (s’di të bëjë keq), *Хлестаков* – *Hlestakov* (gënjeshhtar, llafazan), *Мышкин* – *Mishkin* (me tipare si të miut, i shkathët, dinak), *Собакевич* – *Sobakjeviç* (me prirje shtazore), *Овсов* – *Ovsov* – (të kujton tërshërën, tagji për kuajt, njeri i rëndomtë, pa karakter).

Në letërsinë klasike ruse simbolika e antroponimeve, të trilluara nga autori, është mjaft e pasur dhe e larmishme. Për përkthyesin është e rëndësishme të dallojë emrin a mbiemrin e trilluar nga emrat e personazheve të tjerë realë, të përdorur në veprë. Jo gjithmonë semantika e emrit/mbiemrit të trilluar gjendet lehtë, domethënia e tij duhet kërkuar, p.sh. mbiemri *Елдырин* (Jelldirin), i përdorur nga Çehovi në tregimin “Kameleoni”, vjen nga folja *елдыжит* (jell dizhit) me kuptimin “zihet, kurdis grindje”, veçanërisht kur bëhet fjalë për të ndarë diçka. Prej saj formohet emri *Jelldiga*, të cilin autori e ka transformuar në *Elldirin* (njeri egoist, interesaxhi). Kur rrok domethënien e

antroponimit, lexuesi e pasuron perceptimin e vet për personazhin, por dhe për qëndrimin e autorit ndaj heroit të veprës.

Në një tekst letrar emrat e përveçëm të krijuar nga vetë autori, krahas funksionit emërtues, kryejnë dhe funksione stilistike, më shpesh informuese (nëpërmjet formës së brendshme të emrit ose kuptimit etimologjik), më rrallë emocionale, ngjallin ndjenja të caktuara te lexuesi, ku rol të rëndësishëm luan ndërtimi fonetik dhe fjalëformues i njësisë antroponimike. Edhe funksioni shprehës është komponent shumë i rëndësishëm i tyre. Ka disa faktorë që ndikojnë në shprehësinë e emrave të trilluar:

a) forma e brendshme e emrit për të karakterizuar personazhin: *Zverkov* (si kafshë grabitqare), *Stegunov* (i arsyeshëm, i qetë) [Turgenjev, “Kujtimet e një gjahtari”];

b) të ashtuquajturit emra të dalë mode, pak të përdorur, por që shprehin ironi e antipati ndaj personazhit ose gjendjen e tij shoqërore: *Akaki Akakjeviç* [Gogol, “Manteli”];

c) veçoritë strukturore të emrit të përveçëm (me ose pa mjete ndajshesore) e bëjnë më të theksuar efektin shprehës, p.sh. prapashtesa *-ск-уї (-sk-ij)* i jep konotacion negativ, fyes mbiemrit të njërit prej personazheve të Çehovit *Дрянковский* – Drjankovski (nga emri *дрянь* – fundërrinë, i poshtër), ndërsa emri pa elemente morfologjike *Прыц* – Prishç (puçërr) te veprat e Salltikov-Shçedrinit e bën formën e tij të brendshme të jetë më e drejtpërdrejtë;

d) shprehësia e ndërtimit fonetik, e krijuar nga autori me anë të përsëritjes së tingujve të veçantë ose grupeve të tingujve me ngjyime emocionale: *графиня Хрюмина* – kontesha Hrjumina (elementi *hrju* të kujton hungëritjen e dërrit). Të gjitha këto veçori të funksionimit të emrave/mbiemrave të përveçëm, që karakterizojnë personazhin e veprës, kërkojnë qasje të veçantë në përkthim. Si rregull ato lihen si në origjinal, por në shfaqjen e parë përkthyesi ose redaktori, kur konteksti nuk ndihmon perceptimin e tyre, mund të japin shpjegime për domethënien e tyre.

Në praktikën përkthimore antroponime të tilla në shumicën dërrmuese të rasteve transkriptohen, por informacioni që ngërthen secili prej tyre për një lexues që nuk njeh rusishten, humbet, mbetet i pazbuluar. Transkriptimi pa kompensim i semantikës së tyre çon në humbje funksionale, antroponimi në përkthim nuk përmbush funksionin e tij kryesor shprehës dhe vlerësues. Po sjellim disa shembuj. Mbiemrat e dy personazheve në tregimin “Vdekja e nëpunësit”, të sajuar nga Çehovi si *Червяков* për nëpunësin dhe *Бризжалов* për gjeneralin, në përkthim janë transkriptuar në *Çervjakov* dhe *Brizhhallov*. Mbiemrin e nëpunësit autori e ka trilluar nga emri *червь* – *червяк* (krimb), ndërsa mbiemrin e gjeneralit nga folja *брюзжать* (bërtas, shaj, dal nga vetja). Pikërisht kjo përmbajtje e mbiemrave të dy personazheve pa shpjegime të përkthyesit e zbeh efektin humoristik të tregimit, por edhe idenë e autorit se

nga një teshtitje e pakujdesshme vdiq para zyrtarëve me pozitë më të lartë jo njeriu, por nëpunësi.

Vetëm me transkriptim kanë mbetur në të dy përkthimet e romanit të M. Bullgakovit “Mjeshtri dhe Margarita” mbiemrat e përveçëm *Бездомный* - Bezdomni (i pashtëpi, i pastrehë), *Варенуха* - Varenuha (i dhënë pas pijes), *Босой* - Bosoi (këmbëzbathur) etj. Përfshirja në vepër e personazheve me mbiemra të tillë nuk është e rastësishme. Ndryshe nga disa mbiemra të tjerë në roman (*Стравинский*, *Кузьмин*, *Бернадский*), ato janë ndër personazhet kryesore të romanit, të cilët në tekstin e përkthimit s’duhen lënë “memeçë”, vetëm me një transkriptim a transliterim të thjeshtë. Ndryshe është vepruar nga dy përkthyesit e këtij romani (ndër rastet e rralla) me mbiemrin e personazhit (*Марк*) *Крысобою*. *Mark Krisoboi* në roman kryen detyrën e komandantit të Legjionit të Pestë Maqedonas, bashkëluftëtar i vjetër dhe roje i Pons Pilatit. Si mbiemër për të autori ka zgjedhur nofkën e përbërë nga dy pjesë të kuptimshme *kris* (mi) + *boj* (luftim), të cilat në shqip janë dhënë si (*Mark*) *Mivrasësi* (përkthyesi i parë) dhe (*Mark*) *Mitherësi* (përkthyesi i dytë). Pa bërë ndonjë vlerësim për kalkimin e përkthyesve, po nënvizojmë se teknika e përdorur në këtë rast është zgjidhje më e mirë se transkriptimi, megjithatë mbiemri i kalkuar nuk na ndihmon shumë në zërthimin e idesë së autorit. Rimarrja prej tij e teknikës së shfarosjes së minjve nga koha e romakëve nuk është e rastësishme. Shfarosja e tyre në atë kohë bëhej sipas një teknike të veçantë: në kuti të mbyllura futnin minj, të cilët i linin pa ushqim. Për të mbijetuar ata hanin njëri-tjetrin, në fund mbetej miu më i fortë që kishte ngrënë të gjithë të tjerët. Miu fitimtar shfaqej si krijesë vigane, e egër dhe e pamëshirshme, që përdorej përsëri për të zhdukur minj a brejtës të tjerë. Një egërsirë të tillë përfaqëson *Mark Krisoboi*. Përfshirja roman e një xhelati të tillë të ftohtë dhe të bindur, ka kontekst politik. Për Bullgakovin, siç vënë në dukje disa studiues të tij, gjatë Luftës Civile në Rusi (1917–1922) ishte dalluar për pamëshirshmërinë e tij *Lev Trocki*, i cili, ashtu si *Mark Krisoboi* në roman (komandant ushtarak nën sundimtarin suprem të Judesë, Pons Pilatit), faktikisht luajti të njëjtin rol në Rusi nën udhëheqjen e Leninit. Autori u referohet personazheve të Romës së lashtë për të rikrijuar frymën e periudhës së pasrevolucionit në Rusi, kur shpalosen ngjarjet në roman. Paralelizmi i zhdukjes së minjve në luftën e tyre për mbijetesë dhe i udhëheqësve të grupimeve politike në Rusinë e pasrevolucionit, që hanin kokën e njëri-tjetrit në luftën për pushtet, duhej dhënë me një shënim shpjegues në fund të faqes, i cili do të bënte të qartë përdorimin e nofkës *Mivrasësi* nga autori i romanit.

Po sjellim edhe një shembull tjetër ku zëvendësimi i antroponimit rus me leksikon e shqipes ka qenë një zgjidhje përkthimore jo e mirëmenduar. Në novelën e Bullgakovit “Zemër qeni” personazh kryesor është një qen endacak, të cilin autori e përshkruan si trupvogël, topolak, pushator e të ushqyer mirë. I kishin ngjitur nofkën *Шарик* (*Sharik*), sepse ngjante si tullumbace e fryrë. Në

shqip përkthyesi ka parapëlqyer ta zëvendësojë nofkën me emrin *Rrumbullaku*. Pas transplantit të hipofizës dhe testikujve nga një dhurues që po vdiste, qeni u shndërrua në njeri dhe mori mbiemrin *Sharikov*. Edhe përkthyesi formon në shqip mbiemrin me prapashtesën ruse *ov* – *Rrumbullakov*. Pasi mori pamjen e një njeriu me shtat dhe peshë normale qenit i vunë emrin sipas stilit bolshevik të kohës *Полиграф Полиграфович Шариков*, ndërsa në tekstin shqip ky emër tingëllon edhe më shëmtuar *Poligraf Poligrafoviç Rrumbullakov*.

Duhet mirëkuptuar përpjekja e përkthyesit për të krijuar efektin humoristik të nofkës së qenit, por në këtë rast është krejt e padobishme, sepse emri shqip *Rrumbullaku* nuk i thotë asgjë më tepër lexuesit, sesa përkthimi që i ka bërë vetë autori qenit (trupvogël, topolak, i ushqyer mirë). Mbiemri shqip *Rrumbullakov* me formantin onomastik rus *ov* krijon përshtypjen e gabuar të lexuesi sikur personazhi ka rrënjë shqiptare. Zgjidhja përkthimore më e drejtë në këtë rast, sipas nesh, do të ishte transliterimi i emrit dhe mbiemrit *Sharik*, *Sharikov*, sesa zëvendësimi me emër shqip. Mbiemri *Sharikov* (pamja e jashtme e qenit) nuk ka asnjë ngarkesë semantike shtesë, përkundrazi ngarkesën e kanë emri dhe atësia e stilit bolshevik *Полиграф Полиграфовиç*, që u përhapën në Rusi pas Revolucionit të Tetorit në shpërfillje të traditës. [Krahaso raste të tjera emrash të kësaj periudhe nga bashkimi i rrokjeve ose shkronjave të para të fjalëve: *Райти-я* – Rajtia (**Р**айонная **т**ипография/Типография rajonale), *Вист* – Vist (**В**еликая **и**сторическая **с**ила **т**руда/Forca e madhe historike e punës), *Дздрасмыгд-а* – Dazdrasmigda (**Д**а **з**дравствует **с**мычка города и деревни/Rroftë aleanca e qytetit dhe e fshatit)].

VI. Disa veçori e sugjerime për transmetimin dhe drejtshkrimin e njësive toponimike

Është e njohur se organizimi i mjedisit hapësinor në veprat letrare realizohet nëpërmjet sistemit toponimik të tekstit, njësitë leksikore të të cilit kryejnë funksion tekstformues. Duke vendosur personazhin në një mjedis të caktuar, duke emërtuar vendndodhjen e tij, autori bën konkretizimin gjeografik të ngjarjes që përshkruan dhe në njëfarë mënyre karakterizon personazhin, paracakton karakterin e tij dhe zhvillimin e mëtejshëm të subjektit. Ashtu si antroponimet, edhe toponimet janë dëshmitarë të zhvillimit të shoqërisë, pasqyrojnë informacione të rëndësishme, janë burim i pasur dijesh për historinë, gjuhën dhe kulturën kombëtare të një vendi. Ndonjë studiues i vështron emërtimet gjeografike si “histori të shprehur me mjete gjuhësore” (Никонов 2011, 26). Edhe përzgjedhja e toponimeve për veprën letrare nuk është e rastësishme, madje edhe kur ato përmenden shkarazi. Përkthyesi ka për detyrë që këtë “pasuri” të mos e shpërfillë, por ta çojë deri te lexuesi i përkthimit.

Procesi i transmetimit të emërtimeve gjeografike dhe elementeve të tyre fonologjike, morfologjike dhe leksikore nga gjuha ose sistemi grafik i rusishtes në gjuhën ose sistemin grafik të shqipes realizohet nëpërmjet transliterimit, transkriptimit dhe kalkimit, si dhe kombinimeve të tyre në varësi nga veçantitë e secilës njësi antroponimike ose toponimike.

1. Transliterohen ose transkriptohen emërtimet e vendeve, qyteteve, maleve, lumenjve, pyjeve: *Владикавказ – Vlladikaukaz, Волга – Vollga, Екатеринбург – Jekaterinburg, Ижевск – Izhevsk, Камчатка – Kamçatka, Лубянка – Llubjanka, Лучинник – Lluçinik (рул), Нижний Новгород - Nizhni Novgorod, Обь – Ob, Орлов - Orllov, Павловск – Pavllovsk, Петергоф – Petërgof, Приморье – Primorje, Поволжье - Povollzhje, Рыбинск – Ribinsk, Самара – Samara, Сергиев Посад - Sergiev Posad, Татарстан – Tatarstan, Хабаровск – Habarovsk.*

2. Emërtimet e rajoneve, rrugëve, shesheve, si rregull, transkriptohen ose transliterohen: *Арбат – Arbat, Внуково – Vnuково, Ильинка – Ilinka, Крымский вал – Krimski vall, Марсово поле - Marsovo Polje, Мытная – Mitnaja, Мясницкие Ворота – Mjasnickie Vorota; Стромынка – Strominka, Шаболовка – Shabollovka, Хамовники – Hamovniki, Якиманка – Jakimanka.*

3. Kalkohen emërtimet gjeografike kur semantika e tyre është e qartë dhe toponimi i kalkuar është i rëndësishëm për përmbajtjen e tekstit. Gjatë kalkimit përkthyesit të shqipes, sipas rastit, i duhet të kryejë disa transformime: të vendosë mbaresat rasore ose, sipas rastit, të ndryshojë rendin e gjymtyrëve të togfjalëshit e ndonjë ndryshim tjetër.

3.1. Kalkohen emërtimet e objekteve të mëdha gjeografike: të maleve, liqeneve, deteve, oqeaneve. Kalkimi mund të jetë i plotë kur toponimi është togfjalësh me dy a më shumë gjymtyrë të kalkueshme: *Дальний Восток – Lindja e Largët. Северный Ледовитый океан – Oqeani i Ngrirë i Veriut, Солёное Озеро – Liqeni i Kripur.* Me kalkim mund të jepen edhe emërtime objektesh më të vogla: *площадь Морской Славы - Sheshi i Lavdisë Detare, площадь Победы – Sheshi i Fitores.* Edhe emri i sheshit qendror të Moskës *Красная площадь*, historikisht në shqip dhe në gjuhë të tjera ka hyrë i kalkuar si *Sheshi i Kuq* (angl. *Red Square*, gjerm. *Rote Platz*, fr. *Place Rouge*, sp. *Plaza Roja*). Në fakt bëhet fjalë jo për shesh të kuq, por për shesh të bukur. (Kohë më parë mbiemri *красный* në gjuhën ruse përdorej në kuptimin i bukur, krahaso: *краса, красавица, красotka, красивый*).

3.2. Kalkimi mund të jetë i pjesshëm, kur njëra gjymtyrë e toponimit kalkohet, ndërsa gjymtyra tjetër, kalkimi i së cilës është i pamundur, transliterohet ose transkriptohet: *Баренцево море – deti Varenc, Берингов пролив – ngushtica e Beringut, гора Эльбрус – mali Elbrus, Кавказские горы – malet e Kaukazit, Каспийское море – deti Kaspiq, Курильские острова – ishujt Kurile, Ладожское озеро – liqeni i Ladogës, река Волга – lumi i Vollgës, река Нева – lumi i Nevës.* Te toponimi *Земля Франца Иосифа* –

Toka e Franz Jozefit gjejmë të kalkuar vetëm gjymtyrën e parë *Toka*, ndërsa gjymtyra tjetër, antroponimi *Franz Josef*, i huazuar në rusishte si *Франц Иосиф*, në shqip është përdorur si në origjinal *Franz Josef* me ndryshimin e vetëm të zëvendësimit së gjymtyrës *Josef* me *Jozef* sipas traditës katolike shqiptare.

3.3. Ka raste kur gjymtyrët e toponimit, edhe pse janë të kalkueshme, përkthyesi i huazon me transkriptim: *Крестовский остров – Krestovski Ostrov, Охотный Ряд – Ohotni Rjad, Белая Церковь - Bjellaja Cerkov* (qytet) ose huazon vetëm njëri prej gjymtyrëve të toponimit: *Садовое кольцо – unaza Sadovaja* (jo unaza e Kopshtijeve). Nuk kalkohen toponimet e përbëra nga dy tema: *Белгород – Bjellgorod, Зеленоград – Zelenograd, Красногорск – Krasnogorsk, Краснодар – Krasnodar* etj.

Në përkthim ndodh shpesh që toponimi në origjinal nuk saktësohet çfarë përfaqëson konkretisht. Për rusishtfolësin kjo nuk përbën problem, sepse vepra letrare shkruhet për të, por lexuesi i një kulture tjetër e ka të vështirë të hamendësojë saktë njësinë toponimike. Për të orientuar lexuesin e vet përkthyesi e ka të domosdoshme ta konkretizojë toponimin, p.sh. *На Мытной стояла девятка* (Në **rrugën Mitnaja** qëndronte një Lada 9); *Его обогнали около Шестилавочной* (Atë e kaluam (e lamë prapa) afër **rrugës Shestillavoçnaja**); *Кто бывал на Курилах?* (Kush ka qenë në **ishujt Kurile?**); *Его город находится на Иртыше* (Qyteti i tij ndodhet **buzë lumit Irtysh**). Toponimet e mësipërme janë konkretizuar duke i shtuar antroponimit një emër të përgjithshëm, përndryshe lexuesi i përkthimit mund t'i marrë për objekte të ndryshme gjeografike. Po sjellim edhe një shembull tjetër nga romani "Idioti" i F. Dostojevskit: *Генерал Епанчин жил в собственном доме, несколько в стороне Литейной* (vëll.6 f.4). Toponimi *Литейная*, duhet konkretizuar, përndryshe lexuesi do ta hamendësojë si ndërtesë, fabrikë ose objekt tjetër. (Gjeneral Jepançini jetonte në shtëpinë e tij, në krah të **rrugës Litejnaja**). Mendojmë se toponimi në fjalë ka nevojë edhe për një shpjegim tjetër. Rruga *Litejnaja* është zgjedhur jo rastësisht nga autori. Kemi të bëjmë me një emërtim historik, i cili lidhet me urdhërin e Pjetrit I për të krijuar në Petërburgun që po ndërtonte një lagje me punëtorë e armëpunues, të mbledhur nga Moska e Tula, me të dënuar me punë të detyruar, me robër suedezë etj., të cilët do të derdhnin topa lufte. Prej këtej rruga ka marrë emrin *Litejnaja* (nga folja ruse *лить* – derdh, shkrij metal) që e mban edhe sot, por në përkthim ky informacion ka humbur dhe toponimi perceptohet si një rrugë çfarëdo.

Për të kuptuar me sa humbje përkthejmë po analizojmë transmetimin e toponimit tjetër historik *Божedomка (Bozhedomka)*, të përdorur nga Bullgakovi në romanin "Mjeshtri dhe Margarita" në tekstin e mëposhtëm: *...супруга Стёпы якобы обнаружилась на Божedomке... - e shoqja e Demkës që shfaqur në **Bozhedomkë**...*

Në përkthim toponimi i transliteruar si *Bozhedomkë* mbetet i pakuptueshëm për lexuesin. Ai nuk gjen asnjë të dhënë që ta orientojë se ku gjoja ishte parë e shoqja e Stjopës (jo e Demkës), në rrugë?, në një ndërtesë?, në shesh? Përkthimit i mungon saktësimi i vendit (në *rrugën* Bozhedomka). Ndërhyrja e përkthyesit në këto raste është aq minimale, saqë lexuesit nuk i bie në sy prania e përkthyesit, por puna e tij nuk duhet të mbarojë me kaq. Toponimi i transliteruar në shqip nuk ngjall asnjë emocion, asnjë ndjesi që përjeton lexuesi i origjinalit. Tekstet shqip i mungon informacioni që mbart kulturoni *Bozhedomka*. Bullgakovit ka zgjedhur për të vendosur ngjarjen jo në një rrugë çfarëdo të Moskës, por pikërisht në *Bozhedomkë*, pas së cilës “fshihet” një informacion i pasur historik e kulturor. Është zgjedhur pikërisht kjo rrugë, sepse dikur ajo ndodhej në një rajon periferik të Moskës, sa të çuditshëm, aq edhe famëkeq, ogurzi e kriminal. E kishte marrë emrin nga një shtëpi që gjendej në të, e cila njihej si *Bozhij dom* (Shtëpia e Zotit). Aty gjenin strehën e fundit të varfrit, endacakët, të humburit, të pashpresët. Po kësaj rruge dërgoheshin trupat e të vranëve e të vetvranëve, të vdekurve e të ngrirëve, të mbyturve e të aksidentuarve të paidentifikuar dhe të pakërkuar nga askush. Sipas një tradite të hershme, ata nuk mund të vendoseshin në varrezat e zakonshme, por shtiheshin në një gropë të përbashkët dhe mbuloheshin me akull, e cila për njëfarë kohe (deri nga muaji prill) shërbente si morg me shpresë se dikush mund të identifikohet. Natyrisht, i gjithë ky informacioni i tekstit të përkthimit do t’i mungojë, por për ta ndihmuar lexuesin të depërtojë sadopak në ngarkesën historike të kësaj realie, në mos me zë të plotë, të paktën t’i pëshpëritë, do të duhej shënimi i përkthyesit.

Sfidë për përkthyesin mbeten rastet kur në tekstin letrar, krahas personazheve metaforike, gjejmë edhe toponime të krijuara nga vetë autori, të cilat shërbejnë si simbole a sinjale. Njësia toponimike e trilluar duhet konsideruar jo vetëm si emërtim i një pike në hapësirë, por si element artistik domethënës i veprës. Shpesh toponime të tilla janë potencial njohurish, janë gjurmë e ngjarjeve të caktuara kulturore e historike që zgjohen me vetëdije nga autori. P.sh. në romanin “Vëllezërit Karamazovë” të Dostojevskit qyteti *Скотопригоньевск* (Skotoprigonjevsk) është vendi kryesor ku zhvillohen ngjarjet. Imazhin e tij autori e krijoi mbi bazën e qytetit real të asaj periudhe, *Staraja Russa* (Rusia e Vjetër), ku kaloi mjaft kohë në vitet e fundit të jetës. *Staraja Russa* paraqitet në roman si një prototip i botës ruse të asaj kohe. Topografinë e vërtetë të këtij qyteti Dostojevskit e kodoi në emërtimin *Skotoprigonjevsk* duke e shndërruar në një peizazh simbolik që shprehte frymën e një qyteti provincial rus.

Mënyra alegorike e emërtimit është karakteristike si për emërtimet reale, ashtu edhe për emërtimet e trilluara që përdoren në tekstin letrar, por ato kanë një dallim jo pa rëndësi. Ndryshimi midis tyre është se emërtimet e shpikura të tipit *Skotoprigonjevsk*, ndryshe nga emërtimet reale (p.sh. Petërburg), e

shprehin metaforën në mënyrë eksplicite, ndërsa ato reale vetëm në mënyrë implicite. Toponimi *Skotoprignonjevsk* është metaforë e shprehur qartë: kuptimi i toponimit përbëhet nga emri *ском* (kafshë, bagëti) dhe nga folja e aspektit të pakryer *пригонять* (çoj, shpie ‘vazhdimisht’). Në *Staraja Russa* Dostojevski vuri re se në sheshin e qytetit çonin kafshë për shitje a therje. Qyteti për shkrimtarin ishte kthyer në një hapësirë, ku ndiqeshin tufa-tufa krijesa të ngjashme me kafshët. Kjo nuk ndodhte vetëm në Staraja Russa, por në gjithë Rusinë e shekullit XIX. Kishte ndodhur dhe në të kaluarën, vazhdonte edhe në të tashmen. Ndonjë studiues i Dostojevskit shkruan se kafshët që mbushnin tregun e gjësë së gjallë në mes të qytetit “nuk ishin aspak gjitarë të punëve bujqësore, nuk ishin as kafshë që i detyronin të kryenin punë të rënda, madje s’ishin as njerëz brutalë e të poshtër. Në gjuhën e Dostojevskit fjala *kafshë* më së pari do të thoshte *bishë* dhe bisha për të, sipas teksteve të Shkrimit të Shenjtë, është një nga emrat e djallit” (Азаренко 2012, 187-190). Simbolika e zoonimit, e përdorur nga autori, e zhyt lexuesin e romanit në botën e marrëdhënieve çnjerëzore, prandaj nga fundi i romanit ai e quajti qytetin e vogël provincial *Skotoprignonjevsk*.

Për transmetimin e një emërtimi të tillë përkthyesit e këtij romani janë mjaftuar vetëm me përcjelljen e funksionit emërtues të toponimit, pa u thelluar në motivimin e emërtimit. Vetë toponimi i transliteruar nuk i thotë asgjë shqipfolësit. Edhe nëse do ta kalkonim toponimin *Skotoprignonjevsk*, p.sh. si (qyteti) *Kafshëçojan*, me ruajtje të përmbajtjes kuptimore si në gjuhën ruse, gjithësesi ngjyrimi kombëtar e kulturor i fjalës do të humbiste. Për të mos e lënë krejtësisht të shurdhët lexuesin dhe për të minimizuar humbjen në tekstin e përkthimit, e vetmja “rrugëdalje” do të ishte komenti i përkthyesit (redaktorit) në fund të faqes. Një përvojë e tillë në praktikën përkthimore ekziston, por dhjetëvjeçarët e fundit vihet re prirja për t’i mënjanuar komentet a fusnotat. Është dukuri jo vetëm shqiptare. Pretendohet se shënimet e përkthyesit e shkëputin lexuesin nga rrëfimi i autorit, se lexuesi i ditëve tona i ka mundësitë ta gjejë informacionin e duhur në fjalorë, enciklopedi ose nga burime të tjera të teknologjisë së sotme, por një praktikë e tillë merr kohë dhe është shkurajuese për lexuesin. Shënimi i përkthyesit në rastin e mësipërm duhet parë si zgjidhje përkthimore për të lehtësuar perceptimin e lexuesit.

Nga sa u trajtua më sipër, mund të pohojmë se gjatë transmetimit të toponimeve letrare nga gjuha ruse me alfabet cirilik, ashtu si dhe për antroponimet, përkthyesi mund të përdorë teknikat e transliterimit, transkriptimit, kalkimit ose kombinime të tyre të ndryshme, me gjithë mangësitë që ato kanë. Përzgjedhja e njërës ose tjetrës mënyrë varet nga veçantitë e struktura e toponimeve dhe përvoja e përkthyesit.

4. Për mënjanimin e luhatjeve në drejtshkrimin e disa grupeve toponimesh sugjerojmë:

4.1. Toponimet ruse që mbarojnë me **-be** në shqip duhen dhënë me **-je**: *Заборье – Zaborje, Задорожье – Zadorozhje, Заполярье – Zapolarje, Медвежье – Medvezhdje, Поволжье – Povollzhje, Подмосковье – Podmoskovje, Приамурье – Priaturje, Приладожье – Prilladozhje, Приморье – Primorje*. Variantet me **-ije** ose **-ie** *Primorje, Primorie, Duboviçije, Duboviçie* duhen mënjeluar.

4.2. Toponimet ruse që mbarojnë me elementet **-ск** dhe **-цк**, në trajtën e shquar të shqipes marrin mbaresën **-u** (si emrat e lakimit të dytë): *Архангельск – Arhangelsk-u, Белогорск – Bjellogorsk-u, Брянск – Brjansk-u, Иркутск – Irkutsk-u, Ижевск – Izhevsk-u, Курск – Kursk-u, Мурманск – Murmansk-u, Новороссийск – Novorosijsk-u, Новосибирск – Novosibirsk-u, Новочеркасск – Novoçerkask-u, Норильск – Norilsk-u, Омск – Omsk-u, Смоленск – Smolensk-u, Хабаровск – Habarovsk-u, Челябинск – Çeljabinsk-u, Ульяновск – Uljanovsk-u, Якутск – Jakutsk-u; Белорецк – Belloreck-u, Донецк – Doneck-u, Кузнецк – Kuzneck-u, Липецк – Lipeck-u*.

Mbaresa **-i** te emrat e mësipërm (Izhevsk-i, Omsk-i, Visock-i etj.) është e gabuar.

4.3. Për toponimet e rusishtes me **x** në fillim ose në trup të fjalës, në shqip duhet ruajtur tradita e shkrimit me **h** të shqipes: *Хабаровск – Habarovsk, Харьков – Harkiv, Херсон – Herson, Астрахань – Astrahan, Бахмут – Bahmut, Махачкала – Mahaçkalla, Сахалин – Sahalin*. Variantet me **kh** (*Astrakhan, Khabarovsk, Kharkiv, Kherson, Mahaçkalla, Sakhalin*) janë imitime transkriptimesh të gjuhëve perëndimore dhe nuk pajtohen me fonetikën e gjuhës shqipe, prandaj duhen mënjeluar.

4.4. Transkriptohen gabim nga rusishtja disa toponime të gjuhëve të tjera sllave me alfabet cirilik, p.sh. emrat e qyteteve bullgare *Велико-Търново, Търговище*, për mungesë të fonemës bullgare **ъ** (ë), në gjuhën ruse shkruhen me **ы**: *Търговище, Велико-Търново*. Këto njësi toponimike duhen dhënë në shqip jo nga transkriptimi i rusishtes si gjuhë e ndërmjetme, por me transliterim/transkriptim të drejtpërdrejtë nga gjuha burimore (bullgarishtja) *Veliko-Tërnovo* (jo *Veliko-Tirnov*), *Tërgovishte* (jo *Tirgovishte*). (Për analogji: toponimet e frëngjishtes *Versailles, Marseille* nuk mund të transkriptohen nga rusishtja si *Версаль, Марсель*, por nga origjinali *Versajë, Marsejë*).

4.5. Shenja forcuese **ъ** në trup të fjalës dhe shenja zbutëse **ь** në fund të fjalës nuk pasqyrojnë asnjë tingull. Në transmetimin e emrave të përveçëm funksioni i tyre në këto pozicione bie, humbet: *Кизилъюрт (qytet) – Kizilljurt; Астрахань – Astrahan, Казань – Kazan, Керчь – Kerç, Кубань – Kuban, Пермь – Perm, Рязань – Rjazan, Тверь – Tvjer, Тюмень – Tjumen*. Kjo mënyrë shkrimi është tashmë një praktikë e ngulitur në gjuhën shqipe, prandaj format me **-nj** ose me apostrof duhen mënjeluar (Rjazanj, Kazan’).

4.6. Shkrimi i disa toponimeve është ngulitur prej kohësh në gjuhën shqipe dhe vazhdon të ruhet i tillë: *Kremlin* (Кремль), *Krime* (Крым), *Moskë*

(Москва), *Siberi* (Сибирь), *Çeçeni* (Чечня). Shkrimi tradicional i emërtimeve të tilla gjeografike ka përparësi ndaj çdo rregulle të transkriptimit të sotëm.

Nga shqyrtimi i mësipërm mund të pohohet se për transmetimin e emrave/mbiemrave të përveçëm të njerëzve dhe të emërtimeve gjeografike, të përdorura në letërsinë artistike, nuk ekziston asnjë metodë universale. Mënyrat më të përhapura për të përcjellë në shqip antroponimet dhe toponimet ruse (reale ose të trilluara) janë transkriptimi, transliterimi, kalkimi ose kombinimi i tyre. I takon përkthyesit të vendosë cila teknikë përkthimore është më e përshtatshme për njërën a tjetrin onim.

Përfundime

Transmetimi i emrave të përveçëm vetjakë dhe të vendeve të onomastikës letrare ruse paraqet vështirësi të karakterit objektiv e subjektiv: *së pari*, metodat përkthimore që përdoren janë heterogjene, përkthyesit tanë akoma nuk kanë në dorë një sistem të unifikuar transkriptimi a transliterimi të njëjësive antroponimike e toponimike nga gjuha ruse me alfabet cirilik. Edhe kur përkthyesit i duhet të vendosë të ndryshojë (zëvendësojë) emrin/mbiemrin e personazhit, ai përsëri gjendet përpara mungesës rregullave dhe parimeve. Edhe në këtë rast ai që vendos është përkthyesi me intuitën e tij; *së dyti* disa parime e rregulla për transmetimin e emrave të përveçëm nga gjuha ruse, të përfshira në Fjalorin Drejtshkrimor të vitit 1973, janë vjetruar dhe kanë nevojë të rishikohen e të riformulohen, ndonjëra duhet zhbërë; *së treti*, edhe për shënimet shpjeguese ose komentet e mundshme të përkthyesit ose të redaktorit, nuk ka rregulla të gjithëpranuara, madje nuk ka as qëndrim, nëse duhen ose nuk duhen. Mund të sillen argumente pro dhe kundër përdorimit të shënimeve të përkthyesit në fund të faqes, por çfarë duhet të bëjë përkthyesi me emra personazhesh historikë a mitologjikë, të cilët janë përfshirë në tekstin letrar jo rastësisht? Jo gjithçka mund t'i lihet nuhatjes letrare të përkthyesit; *së katërti*, figura qendrore në ndërmjetësimin ndërghjuhësor dhe ndërkulturor gjatë procesit përkthimor është përkthyesi. Në mjaft raste shmangiet, shtrembërimet, pasaktësitë ose humbjet përkthimore vijnë nga mungesa e profesionalizmit të tij. Ka ardhur koha që edhe veprimtaria përkthimore të rregullohet me ligj: ai që dëshiron të merret me përkthim të paktën duhet t'i nënshtrohet certifikimit.

Parashtrimi i mësipërm nuk është shterues. Çështja e transmetimit të njëjësive antroponimike e toponimike të rusishtes në shqip mbetet e hapur. Rekomandimet e sjella në materialin e paraqitur mund të jenë një ndihmesë modeste për përkthyesit dhe për gjuhëtarët që merren me drejtshkrimin e shqipes.

Përkthimet e veprave të vjela

V. Azhajev. *Larg Moskës*, 1951

A.S. Pushkin. *Vajza e kapitenit*, V. Kokona, 1954

- A.S. Pushkin. Bija e kapitenit, F. Salihu, E. Rukovci, 2018
 L. Ulickaja, Kazusi Kukocki, S. Gjerasi, 2007
 J. Brodski. Pikëllim dhe arsye, K. Hoxha, A. Tufa, 2018
 A.I.Kuprin. Tregime të zgjedhura, J. Doksani, 2014
 A.S. Pushkin. Eugjen Onjegini, V. Ziko, 2023
 L.N. Tolstoi. Novela, G. Halilaj, V. Kokona, D. Lazri, A. Koçi, 1990
 F.M. Dostojevski. Net të bardha, I. Spahiu, 2007
 A.S. Pushkin. Veprat dramatike, V. Ziko, 1999
 F. Dostojevski. Kujtime nga shtëpia e të vdekurve, Ç. Kurti, 2004
 L. N. Tolstoi. Lufta dhe paqja, S. Caci, bot. II, 1989
 K. Paustovski. Shporta me boçet e bredhit, S. Sheperi, V. Kokona etj. 2003
 A.S. Pushkini. Dubrovski dhe mbikëqyrësi i stacionit, F. Dibra, 2010
 A:P. Çehov. Një histori e mërzitshme, G. Halilaj, 2003
 I.S. Turgenjev. Ujrat pranverore, J. Bllaci. 1992
 M. Bullgakov. Mjeshtri dhe Margarita, L. Bare, 1994
 M. Bullgakov. Mjeshtri dhe Margarita, A. Koli, 2020
 A. P. Çehov. Novela 1, (grup përkthyesish), 2002
 L.Tolstoi. Lumturia martesore, B. Hudhri, 2020
 A.P. Çehov. Tregime & Novela, G. Halilaj, 2014
 Autorë të ndryshëm. Tregime & novela, Xh. Lloshi, 2015
 M. Bullgakov. Zemër qeni, R. Vullkani, 1995
 M. Gorki. Vepra, vëllimi II, tregime, (grup përkthyesish), 1984
 I. Turgenjev. Etër dhe bij, D. Shaplo, 2002
 L. N. Tolstoj. Ana Karenina 1, V. Kokona, 2006
 N. Gogol. Frymë të vdekura, M. Kuteli, 2012
 F. Dostojevski. Shënime nga bodrumi, N. Saiti, 2018
 V. Nabokov. Lolita, B. Muço, 2005
 M. Shollohov “Doni i qetë”, J. Doksani, 2001
 F. Dostojevski. Vëllezërit Karamazov 1, S. Gjerasi, 1993

Bibliografi

- Азаренко Н. А. 2012. *Особенности метафоризации художественного пространства в романах Ф. М. Достоевского. Современная лингвистика и литературоведение. № СибСкрипт № 5-6 (039-040), 187-190. Кемерово: Кемеровский государственный университет.*
- Виноградов В.С. 2006. *Перевод: Общие и лексические вопросы. Учебное пособие. – 3-е изд. – М.: КДУ, 240 с.*

- Влахов С., Флорин С. 1986. *Непереводимое в переводе*: Москва: Высш. шк., 416 с.
- Гиляревский Р. С., Старостин Б. А. 1985. *Иностранные имена и названия в русском тексте*: Москва: Высшая школа, 303 с.
- Горбаневский, М.В. 1988. *Ономастика в художественной литературе*: Филол. Этюды 1. М.: Изд-во Ун-та дружбы народов, 87 с.
- Ермолович, Д.И. 2001. *Имена собственные на стыке языков и культур*. М.: Р.Валент, 200 с.
- Lloshi, Xh. 1973. “Emrat e përveçëm të gjuhëve sllave në drejtshkrimin e shqipes”. *Kongresi i Drejtshkrimit të Gjuhës Shqipe*, 20-25 nëntor 1972, II, Tiranë.
- Ковалев, Г. Ф. 2014. *Избранное. Литературная ономастика*. Воронеж : Издательство Научная книга, 447 с.
- Красавченко Т.Н. 2019. *Теория и практика перевода: Русская классика в Великобритании и США в прошлом и настоящем*. Нё: Социальные и гуманитарные науки. Отечественная и зарубежная литература. серия 7: литературоведение, Институт научной информации по общественным наукам РАН, 2, с. 41-45
- Никонов В.А. 2011. *Введение в топонимику*. М.: Издательство ЛКИ, с. 26.
- Подольская, Н.В. 1988. *Словарь русской ономастической терминологии*. Москва: Наука, 192 с.
- Спачиль, О. В. 2021. *Имя собственное в литературном переводе*: учеб. пособие. Краснодар, 172 с.
- Суперанская, А. В. 2018. *Теоретические основы практической транскрипции*. Москва: ЛЕНАНД , 288 с.
- Швейцер, А.Д. 1988. *Теория перевода (статус, проблемы, аспекты)*, М. "Наука", 215 с.
- Hervey, S. Higgins, I. 1992. *Translation*: S. Hervey, I. Higgins. – London; N.Y.: Routledge, 258 p.
- Newmark, P. 1988. *A textbook of Translation*. London: Prentice Hall, 70 p.
- Vehbiu, A. 2020. “Drejtshkrimi i emrit të huaj”. *Peizazhe të fjalës*, 5 mars. [https://peizazhe të fjalës.com](https://peizazhe_të_fjalës.com)

SUMMARY

Proper literary names and problems of their transmitting from the Russian language

The article points out the challenges faced when transmitting personal proper and place names from Russian literary works into Albanian. Since Russian uses the Cyrillic alphabet and Albanian uses the Latin one, transmitting proper names from Russian literary works presents not a few difficulties. Despite the strong tradition that has developed over the years, many instances of errors and incorrect translation choices persist.

An analysis of Albanian translations of over 30 works by Russian authors in the last 70 years has demonstrated that the difficulties of transmitting Russian proper names into Albanian are due to a variety of causes. Among these causes, several stand out: differences in the phonetic system of these two languages and the different alphabets they use; the absence of a unified system for the transliteration of the anthroponymic and toponymic names; an insufficient set of rules and principles governing the translation of proper names from Russian; the obsolescence of some of the rules of the 1973 Albanian Orthographic Dictionary (Fjalori Drejtshkrimor), along with other factors. A direct result of these factors has been the erroneous translation choices, including the presence of several Albanian variants of Russian anthroponymic or toponymic names, as well as the distortion of Russian names.

A significant challenge faced by translators is when transmitting proper names created by the authors themselves. Besides their naming function, these names often carry an extra semantic coloring aimed at achieving characterization. Often the Albanian translators have unified these proper names, but a different approach is required to create names that would convey the extra information they contain. The article provides concrete examples and relevant recommendations.

Aside from the aforementioned causes, some deviations, distortions, and inaccuracies have resulted from the translators' lack of professionalism. Translations of Russian literary works have been undertaken not only by experts with philological backgrounds and specialists in the Russian language and literature but also by professionals from other fields (geologists, engineers, military, etc.), who primarily knew spoken Russian. It's only natural that their lack of qualifications has often made it challenging, if not outright impossible, to cope with the linguistic as well as non-linguistic difficulties when transmitting Russian proper names into Albanian.

The article aims to propose a more durable solution for the translation of these proper names, benefiting translators and editors of translations of literary works from Russian into Albanian. Additionally, it contributes to furthering the academic discussion on transmitting proper names.